

# RRITJA E BASHKËPUNIMIT DHE KOORDINIMIT **NDËRMJET PROKURORISË DHE POLICISË GJYQËSORE NË SHQIPËRI**

Tiranë, 2019



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Prezenca në Shqipëri**



# RRITJA E BASHKËPUNIMIT DHE KOORDINIMIT NDËRMJET PROKURORISË DHE POLICISË GJYQËSORE NË SHQIPËRI

*“Çdo tullë ka vendin e vet në ndërtimin e një muri.” (OPGJ në shërbime)*

Tiranë, 2019

Autor: Rositsa Zaharieva  
*Konsulente Ndërkombëtare*

© Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përmbajtja e këtij publikimi mund të përdoret lirisht dhe të kopjohet për qëllime edukative dhe qëllime të tjera jo tregtare, me kusht që çdo riprodhim i tillë të shoqërohet me një thënie që njeh OSBE si burim.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë, dosmosdoshmërisht, qëndrimin zyrtar të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Prezenca në Shqipëri**



# Përmbajtja

<b>Permbledhje Ekzekutive .....</b>	<b>6</b>
Shkurtime .....	8
<b>1. Hyrja dhe Konteksti.....</b>	<b>9</b>
1.1 Metodologjia .....	10
<b>2. Kuadri Ligjor .....</b>	<b>12</b>
2.1 Prokuroria e Shqipërisë .....	12
2.1.1 Statusi i prokurorëve .....	12
2.1.2 Struktura dhe organizimi i prokurorisë .....	13
2.1.3 Roli i prokurorëve në procedimet penale .....	14
2.2 Policia Gjyqësore në Shqipëri .....	15
2.2.1 Statusi i oficerëve të policisë gjyqësore.....	15
2.2.2 Struktura dhe organizimi i Policisë Gjyqësore.....	16
2.2.3 Roli i Policisë Gjyqësore në Hetimet Penale.....	16
<b>3. Mekanizmat proceduralë, praktikat formale dhe informale të bashkëpunimit ....</b>	<b>18</b>
3.1 Varësia metodologjike dhe funksionale e Policisë Gjyqësore .....	18
3.2 Roli i prokurorisë në zhvillimin në karrierë të oficerëve të policisë gjyqësore .....	18
3.3 Ngritja e ekipeve të përbashkëta të përhershme dhe të përkohshme .....	19
3.4 Urdhrat me shkrim dhe komunikimi informal .....	19
<b>4. Analiza e gjetjeve të pyetësorit dhe të intervistave të administruara nga Prezenca e OSBE-së .....</b>	<b>20</b>
4.1 Çështje të përgjithshme në lidhje me bashkëpunimin, bashkërendimin dhe komunikimin në procedimet penale.....	20
4.2 Rolet gjatë hetimeve .....	26
4.3 Roli drejtues .....	28
4.4 Zinxhiri i Komandës .....	30
4.5 Strategjia e hetimit .....	31
4.6 Ndjekja e hetimeve .....	33
4.7 Hetimi dhe mbledhja e provave .....	34
4.8 Raportimi.....	35
4.9 Përkatësia gjinore .....	36
4.10 Trajnimi dhe udhëzimet.....	37
<b>5. Përmbledhje e gjetjeve kryesore .....</b>	<b>39</b>
<b>6. Rekomandime .....</b>	<b>42</b>
6.1 Masat në nivel legjislativ dhe rregullator .....	42
6.2 Masat në nivel organizativ .....	43
6.3 Masat për ndërtimin dhe forcimin e kapaciteteve .....	43
<b>7. Referencat .....</b>	<b>44</b>
7.1 Bibliografia .....	44
7.2 Instrumentet ligjore .....	45

## Përmbledhje Ekzekutive

Ndryshime të konsiderueshme legjislative shënuan fillimin e reformës së drejtësisë në Shqipëri. Përveç ndryshimeve në Kushtetutë në vitin 2016, ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale në vitin 2017, hartimi i ligjeve të reja për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë ofroi garanci të forta ligjore për pavarësinë e prokurorisë dhe konfirmoi rolin drejtues të prokurorëve në hetimet penale. Ligji i miratuar së fundmi për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore solli ndryshime të rëndësishme organizative për përmirësimin e rolit hetues të oficerëve të policisë gjyqësore dhe konfirmoi rolin drejtues të prokurorëve.

Gjetjet dhe rekomandimet për zbatimin e *aquis* të BE-së sugjerojnë përfundime të mëtueshme të kapaciteteve të institucioneve shqiptare në fushën e shtetit të së drejtës. Përveç kësaj, vëzhgimet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri mbi dinamikën e ndërveprimit mes prokurorëve dhe policisë gjyqësore tregojnë se një numër i madh prokurorësh nuk luajnë prapëseprapë rol drejtues apo rol proaktiv gjatë fazave hetimore të procedimeve penale, duke e lënë në këtë mënyrë policinë gjyqësore me mundësitë e veta dhe duke e bërë më të vështirë rolin e saj në hetimet paraprake. Kjo situatë aktuale ndikon përgjithësisht në procedimin dhe gjykimin e suksesshëm e çështjeve penale dhe sidomos të atyre veprave penale që lidhen me korrupsionin.

Ky studim ka për qëllim të studiojë dhe të analizojë situatën aktuale të bashkëpunimit, koordinimit dhe komunikimit mes prokurorisë dhe policisë gjyqësore në Shqipëri me qëllim identifikimin e problemeve ekzistuese që kanë lidhje me normat, aspektin profesional dhe qëndrimin e palëve, si dhe bërjen e rekomandimeve për zgjidhje afatshkurtra dhe strategji afatgjata.

Ky studim paraqet një tablo të kuadrit ligjor në lidhje me (i) statusin e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, (ii) strukturën dhe organizimin e prokurorisë dhe strukturave përkatëse, si dhe organizimin e policisë gjyqësore në shërbime dhe në seksione, si dhe (iii) rolin e prokurorëve dhe policisë gjyqësore në hetimet penale.

Në vijim, studimi trajton mekanizmat procedurale ekzistues dhe praktikën formale dhe informale të bashkëpunimit mes prokurorisë dhe policisë gjyqësore. Më specifikisht, ai merret me varësinë funksionale të policisë gjyqësore dhe me mundësitë ekzistuese ligjore për ofrimin nga ana e prokurorisë të orientimeve metodike dhe me rolin që ajo mund të luajë në zhvillimin në karrierë të oficerëve të policisë gjyqësore. Vëmendja u kushtohet ekipeve të përbashkëta – si atyre të përhershme, ashtu edhe të përkohshme – si një mjet për arritjen e rezultateve më të mira hetimore përmes një bashkëpunimi dhe koordinimi më të mirë. Në fund, ky seksion merret me praktikën e komunikimit mes prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

Bazuar në rezultatet e pyetësorëve dhe intervistave, studimi analizon pikëpamjet dhe opinionet si të prokurorëve, ashtu edhe të policisë gjyqësore. Kjo analizë strukturohet në këto fusha tematike, të cilat fokusohen specifikisht tek: (i) problemet e përgjithshme në lidhje me bashkëpunimin, koordinimin dhe komunikimin mes prokurorëve dhe policisë gjyqësore, *inter alia* fenomenin e rrotacionit të policisë gjyqësore të shërbimeve, mungesën ekzistuese të besimit dhe të qëllimeve të përbashkëta mes aktorëve të ndryshëm, problemet që lidhen me konfidencialitetin e hetimeve, si dhe problemet

që lidhen me cilësinë e punës, (ii) rolet e policisë gjyqësore të shërbimeve dhe të seksioneve në hetimet penale, (iii) rolin drejtues të prokurorisë dhe vështirësitë aktuale në të kuptuarin dhe të ushtruarin e këtij roli (iv) efektin e zinxhirit të dyfishtë të komandës që ekziston aktualisht për oficerët e policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit, (v) strategjinë e hetimit dhe, në mënyrë të veçantë, si aplikohen prioritetet (vi) ndjekjen e ecurisë së hetimeve, (vii) mbledhjen e provave, duke u fokusuar tek aksesit në bazat elektronike të të dhënave, (viii) cilësinë e raportimit, (ix) çështjet gjinore, dhe (x) trajnimin dhe udhëzimet. Analiza i trajton gjithashtu këto veçori nga këndvështrimi i specifikave të hetimit të veprave penale lidhur me korrupsionin.

Analiza e kuadrit ligjor dhe rezultatet e pyetësorëve dhe intervistave çojnë në një seri konstatimesh. Ndonëse ligjet në fuqi mundësojnë një rol të fortë drejtues të prokurorisë, të garantuar nga disa garanci ligjore për pavarësinë e prokurorëve, qëndrimi aktual profesional i shumë prokurorëve kufizohet ende tek përfshirja në mbikëqyrjen e hetimeve paraprake me pak ose aspak iniciativë nga ana e tyre, përveçse çështjeve më komplekse.

Konstatimet tregojnë gjithashtu se policia gjyqësore e seksioneve dhe shërbimeve përballet me sfida të ndryshme, të cilat kërkojnë zgjidhje të ndryshme. Mundësia e policisë gjyqësore të shërbimeve, nga njëra anë, për të kryer hetime cilësore dhe në kohë ndikohet negativisht nga mungesa e personelit të mjaftueshëm dhe të aftë, si dhe nga nevoja për ekuilibrimin e hetimeve me funksionet parandaluese të policisë, duke menaxhuar në të njëjtën kohë pritshmëritë dhe ndonjëherë prioritetet kontradiktore të dy zinxhirëve të komandës – atë të prokurorëve dhe të eprorëve të policisë. Në këtë kuadër, cilësia e raportimit dhe mbledhjes së provave të pranueshme del si një problem i ngutshëm në punën e policisë gjyqësore të shërbimeve. Nga ana tjetër, policia e seksioneve vuan nga mungesa e burimeve teknike dhe operacionale dhe së fundmi – nga mungesa e motivimit, pas hyrjes në fuqi të ligjit të vitit 2019 për policinë gjyqësore.

Një tjetër konstatim kyç i këtij studimi lidhet me problemet e bashkëpunimit që vijnë nga mosbesimi mes prokurorëve dhe policisë gjyqësore, të lidhura ngushtë me mungesën e qëllimeve të përbashkëta. Publikimet në media të bazuara në njoftimet e policisë çojnë në nxjerrjen e parakohshme të sekreteve hetimore. Ndonëse njoftime të tilla në media mund të motivohen nga dëshira për të prezantuar aktivitetet e policisë në mënyrë të favorshme për publikun, ato përbëjnë rrezik për mbylljen me sukses të hetimeve, sjellin presione të panevojshme mbi prokurorinë dhe, në fund, prekin marrëdhëniet e mira mes prokurorisë dhe policisë.

Në fund, studimi merret me mangësitë në lidhje me trajnimet e pamjaftueshme ose të papërshtatshme, me mungesën e mjeteve praktike të përditësuara për prokurorët dhe për oficerët e policisë gjyqësore, si manualë, procedura standarde operimi, lista kontrolli, udhëzues, dhe identifikon fushat më të rëndësishme për ndërhyrje si nga aktorët vendas, ashtu edhe nga ata ndërkombëtarë.

Studimi jep rekomandime për hapat e mëtejshëm të ndarë sipas fushave të ndërhyrjeve: në nivel legjislativ dhe rregullator, nivel organizativ dhe ndërtim kapacitetesh, si dhe masa për zhvillimin e kapaciteteve.

## Shkurtime

KPP	Kodi i Procedurës Penale të Shqipërisë
CMS	Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve
DSIK	Agjencia Kombëtare e Sigurisë
BE	Bashkimi Evropian
NjIF	Njësia e Inteligjencës Financiare
PP	Prokuroria e Përgjithshme
ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
KPGj	Komisioni i Policisë Gjyqësore
OPGj	Oficer i Policisë Gjyqësore
MM	Memorandum Mirëkuptimi
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
Prezenca	Prezenca në Shqipëri
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
ShISh	Shërbimi Informativ Shtetëror
ShM	Shkolla e Magjistraturës
SoP	Procedura Standarde Operimi
SPAK	Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
PP	Prokuroria e Posaçme
SCPO	Prokuroria e Krimeve të Rënda
TIMS	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Total
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin



# 1. Hyrja dhe Konteksti

Procesi i reformës në drejtësi në Shqipëri ka filluar në vitin 2016 me miratimin e ndryshimeve në Kushtetutën e Shqipërisë (këtej e tutje "Kushtetuta"), me qëllim krijimin e një gjyqësori të pavarur dhe vetëqeverisës dhe forcimin e kuadrit legjislativ për ta luftuar korrupsionin në mënyrë më efektive. E ashtuquajtura "paketë e reformës në drejtësi" pas ndryshimeve Kushtetuese përfshinte *inter alia* Ligjin Nr. 95/2016 për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për Luftën kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Ligjin Nr. 96/2016 për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë (këtej e tutje "Ligji për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve"), Ligjin Nr. 97/2016 për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë (këtej e tutje "Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë"). Në vitin 2017 u miratuan disa ndryshime në Kodin e Procedurës Penale të Shqipërisë (KPP), duke rritur autonominë e prokurorëve dhe duke forcuar rolin e tyre drejtues në fazën hetimore të procedimeve penale, si Ligji Nr. 25/2019 për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë Gjyqësore (këtej e tutje "Ligji për Policinë Gjyqësore") në vitin 2019, i cili kishte për qëllim përmirësimin e organizimit strukturor dhe funksional të policisë gjyqësore, si dhe rikonfirmimin e rolit të prokurorit si drejtues i hetimeve paraprake.

Këto masa vlerësohen si hapa të marrë 'për përmirësimin e bashkëpunimit dhe besimit reciprok mes policisë, prokurorëve, si dhe agjencive dhe organeve të tjera përkatëse për zbulimin dhe hetimin e çështjeve penale komplekse'. Ndonëse pranohet se Shqipëria ka shënuar progres në ndjekjen e suksesshme penale të korrupsionit në nivel të ulët dhe mesatar, nuk ka pasur progres të konsiderueshëm në ndjekjen e zyrtarëve të lartë shtetërorë.<sup>1</sup>

Ky Raport është përgatitur në kuadër të projektit të vitit 2019 për "Mbështetjen e institucioneve të drejtësisë dhe procesit legjislativ në Shqipëri" të Departamentit të Prezencës (Prezenca) së OSBE-së në Shqipëri për Shtetin e së Drejtës dhe të Drejtat e Njeriut. Një nga komponentët e këtij projekti është fokusimi tek bashkëpunimi mes prokurorisë dhe policisë në fazën hetimore të procedimeve penale. Ky raport përpiqet të identifikojë çështjet më të rëndësishme normative, organizative dhe etike që ndikojnë në ndërveprimin mes prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në Shqipëri.

Raporti nuk ka për qëllim të ofrojë rekomandime për përmirësimin e institucioneve të drejtësisë apo për procesin legjislativ nga këndvështrimi i përgjithshëm, por të fokusohet vetëm tek mangësitë e procedurave zyrtare ekzistuese dhe praktikat informale në fazën hetimore të procedimeve penale, me qëllim përmirësimin e komunikimit, bashkëpunimit dhe bashkërendimit për kryerjen efikase të hetimeve penale.

Procesi i përgatitjes së Raportit "Për forcimin e Bashkëpunimit dhe Koordinimit mes Prokurorisë dhe Policisë Gjyqësore në Shqipëri" u dha mundësi shumë profesionistëve në fushën e drejtësisë penale të shkëmbenin pikëpamjet, të shprehnin shqetësimet dhe të sugjeronin ndryshime. Në këtë raport përfshihen vetëm ato opinione që u gjyquan të rëndësishme për temën kryesore të tij. Të tjera komente dhe propozime të vlefshme janë shkëmbyer dhe janë mbajtur si duhet shënim për t'u adresuar në kuadrin e nismave të tjera të ndërmarra nga Departamenti i Shtetit të së Drejtës dhe të Drejtave të Njeriut i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Ky raport është hartuar duke pasur parasysh prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në Shqipëri, prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Komisionin e Policisë Gjyqësore, Ministrinë e Brendshme dhe agjenci dhe organe të tjera të rëndësishme qeveritare.

<sup>1</sup> Dokument Pune i Stafit të Komisionit, Raporti i vitit 2019 për Shqipërinë, Bruksel, 29.5.2019 SWD (2019) 215 versioni përfundimtar.

## 1.1 Metodologjia

Procesi i hartimit të këtij Raporti filloi me një analizim dhe vlerësim të kuadrit ligjor në fuqi që rregullon dhe trajton bashkëpunimin mes prokurorisë dhe policisë gjyqësore në Shqipëri. Këtu përfshihen akte ligjore dhe nënligjore, si dhe dokumente të tjera ekzistuese që rregullojnë këtë fushë. Si burime për këtë raport kanë shërbyer përkthimet jo zyrtare nga gjuha shqipe në gjuhën angleze të akteve të vëna në dispozicion nga Prokuroria e Përgjithshme, Autoritetet Policore dhe burime të tjera zyrtare.

Hapi tjetër i radhës ishte analizimi nga Departamenti i Shtetit të së Drejtës dhe të Drejtave të Njeriut i Prezencës së OSBE-së i literaturës përkatëse<sup>2</sup>, hartimi i një pyetësori për prokurorët dhe një pyetësori për oficerët e policisë gjyqësore. Këta pyetësorë përmbanin pak a shumë të njëjtat pyetje me shumë pak ndryshime. Në total, ishin 263 pyetje për prokurorët dhe 262 pyetje për policinë gjyqësore, të grupuara sipas këtyre seksioneve tematike:

- Çështje të përgjithshme që i përkasin Bashkëpunimit, Bashkërendimit, si dhe Komunikimit në Procedimet Penale;
- Rolet gjatë hetimeve;
- Roli Drejtuese;
- Zinxhiri i Komandës;
- Paanshmëria;
- Udhëzimet/Urdhrrat;
- Strategjia e Hetimit;
- Ndjekja e Hetimit;
- Hetimi dhe Mbledhja e Provave;
- Raportimi;
- Shkëmbimi i Informacioneve/Konsultimi;
- Çështjet Gjinore;
- Trajnimi dhe Udhëzimet;
- Hetimi i Veprave Penale që Lidhen me Korrupsionin.

Pyetësorët u administruan në shtatë prokurori (Tiranë, Vlorë, Shkodër, Durrës, Fier, Elbasan dhe në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, si dhe në gjashtë drejtori policie në qarqet Tiranë (përfshirë Prokurorinë e Përgjithshme), Vlorë, Shkodër, Durrës, Fier dhe Elbasan. Në total, u administruan dhe u morën 140 pyetësorë nga prokurorët dhe 234 pyetësorë nga oficerët e policisë gjyqësore. Gjetjet e pyetësorëve u përpunuan dhe u analizuan dhe rezultatet e tyre paraqiten në Raportin Statistikor<sup>3</sup>, i cili është i strukturuar sipas seksioneve tematike të pyetësorëve. Gjetjet që kanë të bëjnë me hetimin e veprave penale që lidhen me korrupsionin pasqyrohen në seksionet përkatëse në varësi të temës specifike.

Gjetjet paraprake dhe hipotezat që dalin nga analizimi i kuadrit legjislativ dhe nga gjetjet e pyetësorëve u përdorën për hartimin e pyetjeve gjysmë të strukturuar për intervista personale anonime me grupe të fokusuar prokurorësh dhe oficerësh të policisë gjyqësore nga prokuroritë dhe drejtoritë e mësipërme të policisë. Këto intervista patën si qëllim të përftonin përshkrime nga vetë pjesëmarrësit të punës së tyre, përvojave dhe opinioneve në lidhje me temën e këtij Raporti. Pyetjet e bëra ishin kryesisht të hapura për t'u dhënë mundësi intervistuesve të shtonin pyetje plotësuese në varësi të përgjigjeve të marra. Duke u prezantuar pjesëmarrësve të grupeve të fokusuar objektivat e këtij Raporti, konfidencialitetin e tij dhe procedurën e ndjekur, pjesëmarrësve iu mor pëlqimi për regjistrimin e përgjigjeve të dhëna.

Duhet theksuar se metodologjia e këtij Raporti nuk parashikonte administrimin e pyetësorëve apo zhvillimin e intervistave me oficerët e policisë gjyqësore në shërbime të tjera përveç atyre të Policisë së Shtetit të Shqipërisë. Megjithatë, në Raport jepen referenca ndaj bazës së informacionit të dhënë gjatë intervistave.

<sup>2</sup> Shih Seksionin 7.1 Bibliografia.

<sup>3</sup> Raporti Statistikor me rezultatet dhe gjetjet e pyetësorit (këtej e tutje "Raporti Statistikor") gjendet në format elektronik si Shtojcë e këtij Raporti.

Përveç kësaj, u zhvilluan edhe disa intervista gjysmë të strukturuar me aktorët jashtë sistemit të prokurorisë dhe policisë në fund të procesit të mbledhjes së informacionit bazë. Këto intervista patën si qëllim vlerësimin e gjetjeve në një kontekst më të gjerë dhe krahasimin e tyre me përvojën dhe perceptimet e palëve të jashtme, kur vjen fjala tek bashkëpunimi mes prokurorisë dhe policisë gjyqësore.

Raporti strukturohet si më poshtë:

Në seksionin e 1-rë jepet objekti dhe konteksti i këtij Raporti dhe shpjegohet metodologjia e tij.

Në seksionin e 2-të bëhet një analizë e kuadrit ligjor ekzistues në lidhje me këtë Raport, duke i kushtuar vëmendje të posaçme statusit të prokurorëve dhe të policisë gjyqësore, strukturës organizative të institucioneve përkatëse dhe rolit të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në hetimet penale.

Në seksionin e 3-të analizohen mekanizmat proceduralë, si dhe praktikat ekzistuese formale dhe informale të bashkëpunimit.

Në seksionin e 4-rt bëhet një analizë e gjetjeve të rëndësishme të pyetësorëve dhe intervistave të zhvilluara nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

Në seksionin e 5-të paraqiten gjetjet kryesore të Raportit.

Seksioni 6 përmban rekomandimet.

## 2. Kuadri Ligjor

Në këtë seksion të Raportit shtjellohen bazat e dispozitave përkatëse të Kushtetutës, Kodit të Procedurës Penale, Ligjit nr. 95/2016 për Organizimin dhe Funkcionimin e Institucioneve për Luftën kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Ligjit nr. 96/2016 për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Ligjit nr. 97/2016 për Organizimin dhe Funkcionimin e Prokurorisë, Ligjit nr.108/2014 për Policinë e Shtetit, si dhe Ligjit nr. 25/2019 për Policinë Gjyqësore.

Përveç kësaj, për qëllime të këtij Raporti jepen edhe një sërë aktesh nënligjore për qëllime analizimi.<sup>4</sup> Ndonëse Ligji për Organizimin dhe Funkcionimin e Prokurorisë specifikon që këto akte miratohen para hyrjes në fuqi të Ligjit, ato mbeten të zbatueshme nëse nuk bien ndesh me të, kështu që në vlerësimin e tyre u tregua kujdes i veçantë për shkak të statusit përgjithësisht të paqartë të zbatimit të tyre. Kjo nuk u bë sa u përket akteve rregulluese të dala pas hyrjes në fuqi të ligjit. Përveç kësaj, nuk u vu në dispozicion për analizë asnjë akt nënligjor i lëshuar në përputhje me Ligjin për Policinë Gjyqësore dhe Ligjin për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

### 2.1 Prokuroria e Shqipërisë

#### 2.1.1 Statusi i prokurorëve

Kushtetuta shpall "pavarësinë e brendshme të prokurorëve për të hetuar dhe për të proceduar në përputhje me ligjin".<sup>5</sup> Statusi i pavarur i prokurorëve pasqyrohet më tej në Kodin e Procedurës Penale dhe në Ligjin për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Shqipëri, i cili i jep fund sistemit të mëparshëm monokratik në funksionimin e prokurorisë shqiptare dhe konfirmon që ushtrimi i funksioneve duhet të bazohet tek "vlerësimi i fakteve dhe interpretimi i ligjit në përputhje me bindjen e brendshme [të prokurorit], pa asnjë ndikim të jashtëm, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, nga asnjë palë dhe për asnjë arsye."<sup>6</sup> Në këtë aspekt, Kushtetuta dhe ligjet u përmbahen standardeve evropiane përkatëse se "pavarësia e prokurorëve nuk është prerogativë apo privilegj i dhënë në interes të prokurorëve, por garanci në interes të një drejtësie të ndershme, të paanshme dhe efikase që mbron si interesat publike, ashtu edhe ato private të personave të prekur."<sup>7</sup>

Me ligjin e ri, prokurorët gëzojnë pavarësi të plotë kur vjen fjala te marrja e vendimeve nëse duhet të ndjekin dikë penalisht dhe për çfarë akuzash, gjë që i nënshtrohet vetëm kontrollit gjyqësor. Prokurorët e nivelit më të lartë kanë autoritetin të garantojnë administrimin si duhet të sistemit dhe konsistencën në zbatimin e ligjit, por nuk mund të ndërhyjnë në vendimet e prokurorëve në çështje konkrete.

Prokurori i Përgjithshëm lëshon udhëzime të përgjithshme me shkrim për prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe mbikëqyr zbatimin e tyre. Prokurori i Përgjithshëm mund të lëshojë udhëzime të tilla për (i) koordinimin e punës mes prokurorive të ndryshme ose mes tyre dhe policisë gjyqësore, të përfshira në hetime të përbashkëta; (ii) garantimin e zbatimit uniform të ligjit dhe ndjekjes penale të bazuar në vendimet gjyqësore; (iii) garantimin e zbatimit të rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër krimit; dhe (iv) çështje të tjera që nuk lidhen me çështje konkrete. Krerët e prokurorive kanë autoritetin të lëshojnë udhëzime të përgjithshme për çështje organizative adresuar prokurorëve në zyrat përkatëse, ndërsa Kryeprokurori i Posaçëm do të jetë kompetent për lëshimin e udhëzimeve të tilla për prokurorët e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) (pas ngritjes së saj).

4 Për listën e plotë të akteve nënligjore, ju lutemi shihni Seksionin 7.1 "Instrumentet Ligjore"

5 Neni 148, pika 2 e Kushtetutës.

6 Neni 25, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale; Neni 3, pika 2 e Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

7 Shih Opinionin nr. 9 (2014) të CCPE-së për normat dhe parimet evropiane në lidhje me prokurorët, paragrafët 38-39.

Në raste përjashtuese, krerët e prokurorive mund të lëshojnë udhëzime për çështje specifike, megjithatë ato janë gjithmonë jo të detyrueshme dhe të arsyetuara.

Si garanci për pavarësinë funksionale të prokurorëve, ligji parashikon një sistem për kundërshtimin si të udhëzimeve të përgjithshme, ashtu edhe të udhëzimeve në çështje specifike: të parat përmes apelimit në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, kurse të dytat duke kërkuar shpjegime të mëtejshme dhe vendim të prokurorit individual të çështjes për mosrespektimin e atyre udhëzimeve.

Përveç masave që garantojnë pavarësinë organizative të prokurorëve, pavarësinë funksionale e garantojnë një sërë rregullash të qarta për rekrutimin, emërimin, transferimin, promovimin dhe delegimin.<sup>8</sup>

### 2.1.2 Struktura dhe organizimi i prokurorisë

Prokuroria e Shqipërisë është e organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor. Rregullat për organizimin e saj mund të gjenden në Kushtetutë dhe në Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë.

Zyra më të lartë në strukturën e prokurorisë është Prokuroria e Përgjithshme, e kryesuar nga Prokurori i Përgjithshëm i Shqipërisë. Prokuroria e Përgjithshme ka juridiksion mbi të gjithë territorin e Shqipërisë në ndjekjen penale të çështjeve kundër Presidentit të Republikës, Kryeministrit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, zëvendësministrave, gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

Disa prokurori pranë gjykatave të shkallës së parë (të quajtura zakonisht prokurori rrethesh) dhe prokurori pranë gjykatave të apelit ushtrojnë juridiksion të përgjithshëm që korrespondon me juridiksionin e gjykatave përkatëse.

Aktualisht, janë dy prokurori me juridiksion të posaçëm - PKR, pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda të shkallës së parë dhe PKRA pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda. Prokuroria e Krimeve të Rënda është kompetente për çështjet e korrupsionit dhe krimin të organizuar, p.sh. krimet e kryera nga grupe të organizuara kriminale, organizata terroriste dhe krime të zyrtarëve të lartë shtetërorë, si dhe gjyqtarë, prokurorë dhe zyrtarë të drejtësisë.

Seksione të Posaçme të Përkohshme janë ngritur në Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe në prokuroritë e Rretheve Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Fier, Korçë Gjirokastrë dhe Lezhë<sup>9</sup>, të cilat merren me çështje të krimin të organizuar, krimin ekonomik dhe korrupsionit, krimin në fushën e substancave narkotike, pastrimit të parave dhe krimeve të kryera nga zyrtarët e lartë (siç përcaktohet në Nenin 132 pika 2 e Kushtetutës). Duke pasur parasysh rëndësinë e hetimeve që u ngarkohen seksioneve të posaçme, ekzistojnë disa dispozita për përbushjen e nevojave të tyre të veçanta, si p.sh. hapësira të posaçme për zyra, shërbime mbështetëse të posaçme dhe dispozita për shmangien e publikimit të sekreteve hetimore (d.m.th. materialet në këtë rast dërgohen direkt, duke anashkaluar shërbimet postare).

Kushtetuta parashikon një strukturë prokurorie të specializuar, konkretisht Prokurorinë e Posaçme. Prokuroria e Posaçme është e pavarur nga Prokurori i Përgjithshëm dhe ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën para Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, si dhe para Gjykatës së Lartë. Prokuroria e Posaçme është kompetente për çështjet e korrupsionit dhe krimin të organizuar, çështjet kundër zyrtarëve të lartë, si Presidenti i Republikës, Kryetari i Parlamentit, Kryeministri, anëtarët e Këshillit të Ministrave, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Kryeinspektorit të Drejtësisë, kryetarët e bashkive, deputetët, zëvendësministrat, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe drejtorëve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose me ligj, si dhe për akuzat ndaj ish-zyrtarëve të përmendur më sipër.<sup>10</sup>

<sup>8</sup> Ligji për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Pjesa III, zhvillimi në karrierë i magistratëve.

<sup>9</sup> Marrëveshje Bashkëpunimi për mundësimin e zbatimit të planit të veprimit për luftën kundër krimin të organizuar mes Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm, datë 6.11.2017 dhe Udhëzimi Nr. 1 i Prokurorit të Përgjithshëm për ngritjen e seksioneve të posaçme, datë 20.02.2018.

<sup>10</sup> Neni 75, germa a e Kodit të Procedurës Penale.

Prokuroria e Posaçme, së bashku me një njësi të pavarur hetimi, Byronë Kombëtare të Hetimit (BKH) do të formojë Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK). Krijimi i Prokurorisë së Posaçme, si dhe i BKH-së janë aktualisht në proces.<sup>11</sup>

Me krijimin e Prokurorisë së Posaçme, Prokuroria e Krimeve të Rënda nuk do të ekzistojë më. Çështjet e hetuara nga Prokuroria e Krimeve të Rënda do të transferohen në Prokurorinë e Posaçme, nëse ato janë pjesë e juridiksionit të parashikuar në nenin 75, germa a e Kodit të Procedurës Penale ose në prokuroritë e rretheve me juridiksion të përgjithshëm. Po ashtu, çdo çështje që deri tani hetohet nga prokuroritë e rretheve me juridiksion të përgjithshëm do të transferohet në juridiksionin e Prokurorisë së Posaçme.

Menaxhimi dhe përfaqësimi i ndjekjes penale në kuadrin e këtij organizimi bëhet përkatësisht nga Prokurori i Përgjithshëm, krerët e prokurorive pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm, krerët e prokurorive të rretheve pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm dhe - pas ngritjes së Prokurorisë së Posaçme, nga Kryeprokurori i Prokurorisë së Posaçme.

### 2.1.3 Roli i prokurorëve në procedimet penale

Funksioni thelbësor i prokurorëve në Shqipëri është ushtrimi i ndjekjes penale dhe përfaqësimi i akuzës në gjykatë në emër të Shtetit.<sup>12</sup> Ai gjithashtu përfshin, *inter alia* edhe kontrollin e hetimeve paraprake dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të policisë gjyqësore<sup>13</sup>, si dhe kryerjen e veprimeve hetimore nëse gjykohen të nevojshme. Prokurori ka të drejtë të mos fillojë ndjekjen penale, të pushojë akuzat apo çështjen, t'i kërkojë gjykatës pushimin e akuzave apo të çështjes, si dhe të kërkojë dërgimin e çështjes për gjykim, si dhe të lidhë marrëveshje bashkëpunimi ose marrëveshje në kushtet e pranimin të akuzave.

Vendimi për ndjekje penale në Shqipëri ushtrohet përmes zbatimit të parimit të ligjshmërisë, domethënë prokurori duhet të ndjekë çdo çështje, kur ka prova të mjaftueshme për vazhdimin e ndjekjes penale.<sup>14</sup>

Ndjekjet penale fillohen nga prokurorët ose me nismën e tyre ose në bazë të kallëzimeve penale të marra nga qytetarët, zyrtarët shtetërorë, personeli mjekësor, etj., të cilat ose paraqiten drejtpërdrejt në prokurori ose në Policinë e Shtetit, e cila ia referon ato më pas prokurorisë. Prokurorët kanë diskrecionin për ta filluar ose jo ndjekjen penale për çështje të caktuara. Vendimi duhet të merret brenda 15 ditësh dhe mosfillimi i procedimit penal është objekt i kontrollit gjyqësor. Kodi i Procedurës Penale nuk parashikon në mënyrë të shprehur mundësinë e prokurorëve për të kërkuar informacione shtesë apo sqarime në rastin e, p.sh., raportimeve të paplota apo të paqarta penale.

Prokurorët kanë autoritetin të drejtojnë hetimet, të kryejnë vetë çfarëdolloj veprimi hetimor që gjykojnë të arsyeshëm dhe t'i delegojnë veprime hetimore policisë gjyqësore.

Pas përfundimit të hetimeve paraprake, prokurori ose ndërmerr veprime për pushimin e akuzave apo të çështjes ose e dërgon çështjen për gjykim. Që të dyja këto veprime kryhen me vendim të gjykatës dhe kërkojnë seanca paraprake në sesione të hapura. Në këtë fazë, gjykata mund të vlerësojë se hetimet paraprake janë të paplota dhe të urdhërojnë përfundimin e tyre, duke dhënë orientimet e duhura dhe, nëse është e nevojshme, veprimet që duhet të kryhen, duke përfshirë - përsëritjen e akteve të pavlefshme dhe provave të papërdorshme nëse është e mundur.<sup>15</sup>

Prokurorët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e fakteve për të cilat janë vënë në dijeni gjatë ushtrimit të detyrave të tyre profesionale; ata nuk mund të nxjerrin asnjë informacion që u është vënë në dispozicion gjatë hetimit, nëse kjo gjë dëmton çështjen. Përveç kësaj, dokumentet në dosjen e çështjes janë sekrete derisa për to të informohet i padituri. Prokurori mund ta vonojë edhe më tej nxjerrjen e këtyre informacioneve, nëse kjo gjë është në interes të hetimit. Bërja publike e dokumenteve hetimore është e mundur vetëm me lejen e prokurorit.

11 Ky përcaktim është i saktë në kohën e realizimit të këtij raporti, d.m.th. në nëntor 2019.

12 Neni 148, pika (1) e Kushtetutës

13 Neni 24, pika (1) e Kodit të Procedurës Penale.

14 Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin, "Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit: Neni 11, udhëzues për zbatimin e saj dhe kuadri vlerësues", pika 162.

15 Neni 332, germa c e Kodit të Procedurës Penale.

## 2.2 Policia Gjyqësore në Shqipëri

### 2.2.1 Statusi i oficerëve të policisë gjyqësore

Policia gjyqësore në Shqipëri luan një rol të pandashëm në sistemin e drejtësisë penale. Në ushtrimin e funksioneve të saj, Policia Gjyqësore orientohet nga parimi i ligshmërisë, barazisë dhe mosdiskriminimit, objektiviteti dhe drejtësia, profesionalizmi dhe ndershmëria në kryerjen e detyrave të saj, duke shmangur konfliktin e interesit, duke garantuar konfidencialitetin dhe sekretin hetimor, si dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.<sup>16</sup>

Funksionet e Policisë Gjyqësore në Shqipëri kryhen nga seksionet e policisë gjyqësore, të ngritura pranë prokurorive dhe nga shërbimet e policisë gjyqësore, të organizuara në strukturat hetimore të policisë së Shtetit, ose, ndër të tjera, edhe në Shërbimin e Sigurisë së Shtetit, Policinë Kufitare, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, si dhe nga BKH-ja.

Duhet theksuar se ndonëse oficerët e policisë gjyqësore në seksione dhe në shërbime ushtrojnë të njëjtat funksione dhe udhëhiqen nga të njëjtat parime, aspekte të caktuara të statusit të tyre janë të ndryshme, p.sh. kriteret e përzgjedhjes, procedurat e emërimit, shpërblimet, transferimi, të cilat përshkruhen hollësisht në vijim.

Ndarja e çështjeve mes seksioneve dhe shërbimeve përcaktohet si rregull nga origjina e referimit dhe iniciativa për hapjen e hetimit. Përgjithësisht, policia gjyqësore e seksioneve kryen hetime penale për një numër të kufizuar çështjes krahasuar me Oficerët e Policisë Gjyqësore të shërbimeve: ose kur zbulimi i një akti penal kryhet drejtpërdrejt në prokurori ose kur hetimi iniciohet *ex-officio* nga prokurori. Në të gjitha rastet e tjera, shërbimet e policisë gjyqësore kryejnë hetime paraprake kur procedura penale është regjistruar në prokurori në bazë të veprës penale që u është referuar.

Krerët e prokurorive, përjashtimisht dhe me kërkesë me shkrim nga prokurori i ngarkuar me hetimin, mund t'i ngarkojnë oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve apo shërbimeve të tjera të kryejnë hetime dhe, nëse kjo masë është e nevojshme, të garantojnë objektivitetin e hetimit.<sup>17</sup>

Oficerët e policisë gjyqësore, si ata të seksioneve, ashtu edhe të shërbimeve, duhet të plotësojnë kriteret e përzgjedhjes në lidhje me përvojën minimale të punës që kërkohet<sup>18</sup>, trajnimin fillestar, të mos kenë qenë të dënuar penalisht dhe të mos kenë qenë objekt sanksionesh disiplinore dhe të kenë figurë të pastër. Për oficerët e seksioneve pragu është më i lartë, duke qenë se për ta aplikohen disa kriteret shtesë, d.m.th. ata duhet të kenë shtetësi shqiptare dhe diplomë të arsimit të lartë. Duhet theksuar se ligji lejon përjashtimin nga kriteri i përvojës minimale të punës dhe përfundimi i trajnimit fillestar për oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve në policinë e Shtetit.<sup>19</sup>

Po kështu, edhe procedurat për përzgjedhjen e oficerëve të seksioneve dhe të shërbimeve ndryshojnë nga njëra-tjetra. Oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve përzgjidhen në bazë të një procesi konkurrimi të hapur dhe transparent të administruar nga Prokurori i Përgjithshëm dhe emërohen nga Komisioni i Policisë Gjyqësore (KPGJ)<sup>20</sup>. Oficerët e shërbimeve në Policinë e Shtetit apo në institucione të tjera shtetërore përzgjidhen sipas rregullave të parashikuara në ligjet e posaçme përkatëse.<sup>21</sup>

Shpërblimi për të dyja kategoritë e oficerëve të policisë gjyqësore përcaktohet në bazë të kriterëve të ndryshme. Paga e oficerëve të seksioneve është një funksion i pagës së prokurorëve të prokurorive përkatëse (d.m.th. 60% e pagës fillestare bruto). Oficerët e policisë gjyqësore në shërbimet e Policisë së Shtetit marrin pagën bazë të oficerëve plus 10%.

Oficerët e policisë gjyqësore mund të dërgohen nga KPGJ-ja për një periudhë të kufizuar kohe nga një seksion apo shërbim në një tjetër seksion apo shërbim nëse ka nevoja organizative apo nevoja për kryerjen e hetimeve për çështje të caktuara.

16 Neni 3 i Ligjit për Policinë Gjyqësore.

17 ibid, Neni 24.

18 Kriteret për përvojë pune ndryshojnë për OPGJ-të në shërbime dhe në seksione ndryshojnë – shih ibid, Neni 16, pika 1(a) dhe Neni 17 (c).

19 Neni 16 dhe 17 i Ligjit për Policinë Gjyqësore.

20 Për më shumë në lidhje me përbërjen e KPGJ-së, shih seksionin 3.2 të këtij Raporti.

21 Neni 18 i Ligjit për Policinë Gjyqësore.

Transferimet e oficerëve të policisë gjyqësore, d.m.th. emërimet në seksione apo shërbime të të njëjtit nivel mund të bëhen në rastin e pozicioneve vakante të përhershme. Ligji parashikon që transferimet të bëhen ose për shkak të ndryshimeve strukturore, me kërkesë të oficerëve përkatës, si masë mbrojtëse për ruajtjen e jetës dhe shëndetit të oficerëve apo atë të familjeve të tyre ose për zgjidhjen e situatave të 'mospajtueshmërisë së vazhdueshme etike dhe kur çdo masë tjetër ka rezultuar jo efiçente.'

Oficerët e policisë gjyqësore u nënshtrohen vlerësimeve periodike të kryera nga KPGJ-ja pas marrjes së opinionit me shkrim të prokurorëve. Mospërmbushja e kritereve të vlerësimit mund të çojë në pushimin e tyre nga detyra.

Ngritja në detyrë e oficerëve të policisë gjyqësore vendoset nga KPGJ-ja mbi bazë merite dhe vjetërsie në punë. Dispozitat e Ligjit të Policisë Gjyqësore nuk bëjnë dallime mes oficerëve të seksioneve dhe të shërbimeve dhe nuk përshkruajnë natyrën e ngritjes në detyrë.

Oficerët e policisë gjyqësore mund të përballen me përgjegjësi disiplinore në ushtrimin e funksioneve të tyre. Prokurori i Përgjithshëm, drejtuesit e prokurorive, prokurorët e ngarkuar me hetimin - në lidhje me çështje specifike apo krerët e institucioneve shtetërore përkatëse që kanë shërbime të policisë gjyqësore kanë autoritetin të ndër marrin masa disiplinore.

## 2.2.2 Struktura dhe organizimi i Policisë Gjyqësore

Seksionet e policisë gjyqësore janë të ngritura në prokuroritë e rretheve me juridiksion të përgjithshëm, pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda dhe Prokurorisë së Përgjithshme. Shumica e oficerëve të seksioneve kanë formim juridik, por mund të rekrutohen edhe persona me formim në fusha të tjera. Aktivitetet e policisë gjyqësore të seksioneve orientohen, koordinohen dhe mbikëqyren nga krerët e prokurorive përkatëse.

Shërbimet e policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit janë të organizuara në përputhje me organizimin e Policisë së Shtetit në drejtori dhe përbëhen nga oficerë dhe agjentë. Oficerët e shërbimeve të policisë gjyqësore i ushtrojnë funksionet e tyre në çdo njësi territoriale ku operon prokuroria e rrethit me juridiksion të përgjithshëm. Brenda njësie territoriale të Policisë së Shtetit, oficerët caktohen në drejtori të specializuara, p.sh. në Drejtorinë e Krimit Ekonomik, Parandalimit dhe Kultivimit të Narkotikëve, Krimet e Trafikimit, Krimet kundër Personit dhe Pronës, etj. si dhe në seksione brenda-përbrenda drejtorive.

Një pikë e veçantë që duhet adresuar është mungesa e konsistencës dhe kohezionit të kuadrit ligjor në lidhje me oficerët e policisë gjyqësore në policinë e shërbimeve në Policinë e Shtetit. Ligji për Policinë Gjyqësore parashikon që funksionet e policisë gjyqësore të ushtrohen *inter alia* nga punonjësit e Policisë së Shtetit, të ngarkuar posaçërisht me kryerjen e hetimeve dhe që janë pjesë e strukturës hetimore, e cila është pjesë e strukturës së përgjithshme të Policisë së Shtetit.<sup>22</sup> Këto dispozita nuk janë futur deri tani në Ligjin për Policinë e Shtetit, duke çuar në një lloj pabarazie në regjimin juridik dhe në nevojën për ndryshime urgjente në Ligjin për Policinë e Shtetit për të mundësuar nga njëra anë krijimin e një strukture të dedikuar brendapërbrenda organizatës dhe, nga ana tjetër, rishikimin e funksioneve të oficerëve të policisë gjyqësore në shërbimin e Policisë së Shtetit, që u jep atyre mundësinë të kryejnë hetime paraprake.

## 2.2.3 Roli i Policisë Gjyqësore në Hetimet Penale

Kuadri ligjor ekzistues<sup>23</sup> përcakton funksionet kryesore të Policisë Gjyqësore në Shqipëri *d.m.th.* marrjen e kallëzimeve për vepra penale dhe parandalimin e pasojave të mëtejshme prej tyre, përgatitjen e bazës për hetimet penale përmes identifikimit të autorëve, mbledhjen e provave dhe kryerjen e veprimeve hetimore të urdhëruara apo të deleguara nga prokurori, si dhe ndihmën në procesin e rikuperimit të aseteve.

Udhëzimet kryesore sa u përket funksioneve të policisë gjyqësore parashikohen në KPP. Policia

<sup>22</sup> Neni 2, pika 6 dhe Neni 4, germa b e Ligjit për Policinë Gjyqësore.

<sup>23</sup> Neni 30 i KPP-së; Neni 5 i Ligjit për Policinë Gjyqësore.



gjyqësore e shërbimeve ka mundësi të kufizuara për të kryer verifikime të zgjeruara paraprake pas marrjes së kallëzimeve për një vepër penale, pasi ajo është e detyruar të njoftojë prokurorin brenda 72 orësh<sup>24</sup>. Megjithatë, ligji parashikon që mbledhja e mëtejshme e informacioneve mund të bëhet pas paraqitjes së referimit në prokurori. Për aktivitete *ex officio* të policisë gjyqësore nevojitet autorizimi dhe mbikëqyrja nga prokurori. Për më tepër, ligji parashikon shprehimisht që oficerët e policisë gjyqësore të jenë të varur nga prokurori në hetimin e çështjeve penale.

Gjatë hetimeve penale, policia gjyqësore ndjek udhëzimet dhe urdhrat e prokurorit. Pas kryerjes së hetimeve të nevojshme, policia gjyqësore ia dërgon të gjitha provat dhe dokumentet procedurale prokurorit, së bashku me një relacion shpjegues që përmban sugjerime për përfundimet e çështjes.

Në procesin e ushtrimit të detyrave të saj, policia gjyqësore është e detyruar të ruajë sekretin hetimor. Për këtë qëllim, ata nuk lejohen të nxjerrin akte dhe dokumente të veprimeve procedurale, përveç prokurorit të ngarkuar me hetimin.

---

24 Neni 293 i KPP-së.

## 3. Mekanizmat proceduralë, praktikat formale dhe informale të bashkëpunimit

### 3.1 Varësia metodologjike dhe funksionale e Policisë Gjyqësore

KPP-ja parashikon se "*prokurori drejton hetimin dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore*".

Ligji për Policinë Gjyqësore vendos rregulla të qarta, përmes të cilave policia gjyqësore është objekt mbikëqyrjeje nga prokuroria si në terma të përgjithshëm, përmes udhëzimeve metodologjike të Prokurorit të Përgjithshëm<sup>25</sup>, ashtu edhe në çështje specifike, kur merr urdhra të detyrueshëm nga prokurori i ngarkuar me hetimin. Ligji e detyron policinë gjyqësore t'i raportojë prokurorit për aktivitetet e ndërmarra në procesin e hetimit paraprak, për rezultatet dhe përfundimet e detyrave që u janë ngarkuar.

Përveç kësaj, për oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve ka edhe një nivel tjetër mbikëqyrjeje. Duke qenë pjesë e pandarë e prokurorisë, aktivitetet e tyre *'drejtohen, koordinohen dhe mbikëqyren'* *ex lege* nga kreu i institucionit përkatës për garantimin e përmbushjes së kërkesave të prokurorëve individualë.

### 3.2 Roli i prokurorisë në zhvillimin në karrierë të oficerëve të policisë gjyqësore

Një risi që solli Ligji për Policinë Gjyqësore është ngritja e një organi kolegjal - KPGJ-së - e cila ka autoritet mbi disa aspekte të zhvillimit në karrierë të policisë gjyqësore. Ndonëse përbëhet nga përfaqësues të policisë gjyqësore të seksioneve, policisë gjyqësore të shërbimeve në Policinë e Shtetit dhe funksionon me rrotacion, nën policinë gjyqësore të shërbimeve në dogana dhe në administratën tatimore, KPGJ-ja kryesohet nga një prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme, i cili i ushtron detyrat e tij me kohë të plotë.<sup>26</sup> Ky format ofron mundësinë që prokuroria të jetë e përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe aktive në zhvillimin në karrierë të oficerëve të policisë gjyqësore dhe sidomos të atyre të shërbimeve të parashikuara në Ligjin e shfuqizuar nr. 8677 për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore.

KPGJ-ja emëron, promovon, transferon dhe vendos për dërgimin e oficerëve të seksioneve me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm. Duhet thënë se transferimi dhe lëvizja e oficerëve të shërbimeve bëhet sipas procedurave të parashikuara nga ligjet e posaçme përkatëse, kurse roli i KPGJ-së kufizohet vetëm me dhënien e miratimit përfundimtar.

KPGJ-ja luan rol të rëndësishëm në disa aspekte të zhvillimit në karrierë të oficerëve të policisë gjyqësore: ajo vlerëson performancën e tyre në punë dhe integritetin profesional, si dhe shqyrton kërkesat për masat disiplinore. KPGJ-ja është gjithashtu në pozicion kyç për kualifikimin dhe zhvillimin profesional të policisë gjyqësore, pasi ajo vlerëson nevojat për trajnim dhe planifikon trajnimet.

<sup>25</sup> Neni 7, pika 6 e Ligjit për Policinë Gjyqësore.

<sup>26</sup> Neni 9, pikat 1 dhe 2 të Ligjit për Policinë Gjyqësore.

### 3.3 Ngritja e ekipeve të përbashkëta të përhershme dhe të përkohshme

---

Ekipet e përbashkëta përdoren shpesh si një mjet për një bashkëpunim më të mirë në hetimet komplekse dhe të vështira.

Përveç procedurës standarde të delegimit të veprimeve hetimore specifike policisë gjyqësore, ka mundësi ligjore, përmes të cilave prokurorët mund të angazhojnë oficerët e policisë gjyqësore në mënyra më komplekse, duke i përfshirë ata në ekipe të përbashkëta dhe në njësi të përbashkëta hetimore. Këto formacione hetimi sjellin si përfitim shfrytëzimin e burimeve të ndryshme dhe mundësojnë komunikim më të afërt dhe bashkërendim më të mirë.

Ligji për Policinë Gjyqësore<sup>27</sup> u lejon prokurorëve, në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të çështjes, të urdhërojnë hetime të përbashkëta hetimore të oficerëve të policisë gjyqësore, si të seksioneve, ashtu edhe të shërbimeve. Këto delegime krijojnë mundësi që të përfitohet nga ekspertiza ligjore dhe njohja e procedurave nga oficerët e seksioneve dhe akses më i gjerë në baza të dhënash dhe në burime të tjera operacionale që kanë oficerët e shërbimeve. Në praktikë, ekipet e përbashkëta që përfshijnë oficerë të seksioneve dhe shërbimeve ngrihen përkohësisht me urdhër të prokurorit.

Përveç mundësisë ligjore për krijimin e ekipeve të përkohshme, ka edhe dispozita për ngritjen e njësisë të përhershme hetimore përmes një Urdhri të Prokurorit të Përgjithshëm të vitit 2009 pas nënshkrimit të një Memorandumi Mirëkuptimi (MM) mes Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrit të Brendshëm, Drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror (ShISh), Kryeinspektorit të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPK) dhe Kreut të Kontrollit të Lartë të Shtetit, me qëllim përmirësimin e cilësisë së hetimeve të veprave penale ekonomike dhe të korrupsionit. Njësitë e përbashkëta janë ngritur si seksione në prokuroritë e Rretheve Tiranë, Durrës, Vlorë, Fieri, Shkodër, Korçë dhe Gjirokastrë. Ato deri tani janë drejtuar nga një prokuror dhe kanë pasur në përbërje oficerë me formimin dhe përvojën e nevojshme profesionale për hetimin e krimit ekonomik dhe korrupsionit. Siç u konstatua gjatë intervistave me përfaqësuesit e prokurorive, këto njësi të përbashkëta dhe të përhershme hetimi nuk janë më funksionale.

### 3.4 Urdhrat me shkrim dhe komunikimi informal

---

KPP-ja kërkon që disa forma komunikimi mes prokurorëve dhe policisë gjyqësore të jenë me shkrim, për shkak të natyrës së tyre procedurale që kërkon përfshirjen e dokumenteve përkatëse në dosjen e gjykimit.<sup>28</sup> Megjithatë, përtej kësaj, nuk jepet asnjë parashikim specifik për mënyrën se si duhet të komunikojnë prokurorët dhe policia gjyqësore për çështje operacionale, gjë që u lejon atyre të zgjedhin format më të përshtatshme apo më përfituese në situata të veçanta. Intervistat me prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore tregojnë se komunikimi formal dhe informal kryhet paralelisht, në varësi të rrethanave. Komunikimi informal ndodh kryesisht kur ka nevojë për sqarime të çështjeve procedurale apo çështjeve ligjore thelbësore dhe kryhet përmes takimeve ose telefonit. E mira e komunikimit verbal, siç tregohet në përgjigjet e pyetësorit, është që është më i shpejtë në kohë dhe ul kohën e zbatimit të udhëzimeve dhe urdhrave.<sup>29</sup>

---

<sup>27</sup> ibid, Neni 26.

<sup>28</sup> Neni 332, germa ë, pika 1 e KPP-së, p.sh. urdhrat për fillimin e procedimeve penale dhe vendimet për shtyrjen e afateve të hetimeve paraprake

<sup>29</sup> Raporti Statistikor, Figura 82.

## 4. Analiza e gjetjeve të pyetësorit dhe të intervistave të administruara nga Prezenca e OSBE-së

Ky seksion i raportit shtjellon dhe analizon gjetjet e pyetësorëve dhe intervistave me prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve për të vënë në pah aspektet më të rëndësishme të bashkëpunimit dhe bashkërendimit mes tyre, si dhe për të përcaktuar faktorët që ndikojnë negativisht në ndërveprimin mes tyre.

Për lehtësi reference, në Raportin Statistikor janë vënë disa shënime që shoqërojnë të dhënat përkatëse nga gjetjet e pyetësorëve. Sa herë që ka qenë e mundur janë cituar edhe prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore që morën pjesë në intervista, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ruajtjes së anonimitetit të burimit.

### 4.1 Çështje të përgjithshme në lidhje me bashkëpunimin, bashkërendimin dhe komunikimin në procedimet penale

Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i mirë mes policisë gjyqësore dhe prokurorëve vlerësohet njësoj si nga prokurorët, ashtu dhe nga oficerët e policisë gjyqësore. Bashkëpunimi efikas shihet si parakushti kryesor për hetimin dhe ndjekjen e suksesshme penale, duke mundur llogaridhënien e përbashkët dhe krijimin e vlerave dhe qëllimeve të përbashkëta.<sup>30</sup>

Ndonëse e vlerësojnë rëndësinë e bashkëpunimit të mirë, shumica e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore e vlerësojnë si të mirë marrëdhënien mes tyre në nivel personal, por shumë prej tyre shprehin shqetësime kur vjen fjala te bashkëpunimi profesional në çështje konkrete. Një pikë që vlen të përmendet është që me ndryshimet e KPP-së, prokuroria nuk është më e centralizuar dhe prokurorët kanë një rol më të fortë drejtues në hetimet penale. Prandaj në kontekstin e hetimeve specifike, bashkëpunimi mes prokurorëve dhe policisë gjyqësore nuk përcaktohet më nga marrëdhëniet institucionale, por nga natyra e marrëdhënies mes prokurorëve individualë dhe oficerëve përkatës.

Për shkak të roleve specifike në procesin e drejtësisë penale, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore i shohin ndryshe çështjet që lidhen me bashkëpunimin dhe bashkërendimin. Pavarësisht kësaj, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve i vlerësojnë njësoj faktorët që kontribuojnë në përcaktimin e natyrës së bashkëpunimit mes tyre:

*"Falë përvojës, unë i njoh problemet prokurori - polici. Shkaqet janë të shumta, por gjithçka fillon nga këndvështrimi strukturor, burimet njerëzore dhe mjetet teknike në dispozicion dhe për më tepër filozofia e policisë që hetimi bëhet si ekip, ku prokuroria dhe policia kanë besim tek njëra-tjetra. Kjo nuk po ndodh. Hetimi ka edhe kosto... Dhe më e keqja është se për 30 vjet rresht, puna hetimore nuk është ndarë nga aspektet operacionale" (prokuror)*

Analiza e përgjigjeve të pyetësorit tregon se prokurorët, policia gjyqësore e seksioneve dhe shërbimeve u referohen të njëjtëve faktorë të jashtëm dhe të brendshëm që ndikojnë tek bashkëpunimi. Legjislacioni në fuqi, ndikimet politike, qarkullimi i oficerëve të policisë dhe besimi janë disa prej elementëve kryesorë që përcaktojnë bashkëpunimin efikas dhe eficient.<sup>31</sup> Pranohet gjithashtu se prokurorët janë më të ekspozuar ndaj ndikimeve të jashtme për shkak të rolit të tyre në hetimet penale, duke qenë se 'ata kanë rol vendimmarrës.'

<sup>30</sup> Raporti Statistikor, Figura 1.

<sup>31</sup> Raporti Statistikor, Figura 2.

Një prej shqetësimeve kryesore kur vjen fjala te bashkëpunimi efikas mes prokurorëve dhe policisë gjyqësore është fenomeni i rrotacionit të oficerëve të policisë gjyqësore të shërbimeve, d.m.th. transferimi i oficerëve nga një drejtori policie në tjetrën ose nga një seksion i një drejtorie në një tjetër. Prokurorët e intervistuar për këtë temë bien dakord se lëvizjet e shpeshta shkaktojnë mungesë stabiliteti në menaxhimin e çështjeve, ndikojnë në specializimin e oficerëve të policisë gjyqësore dhe kanë gjithashtu ndikim negativ te komunikimi dhe besimi.

Transferimet përfshijnë dorëzimin e dosjeve nga një oficer tek tjetri, i cili në shumicën e rasteve është shumë i zënë dhe shumë i ngarkuar dhe ka nevojë ndërkohë të njihet me dosjen. Kur vjen fjala te ndikimi që ka rrotacioni në hetimin e veprave penale specifike, të intervistuarit dhanë si shembull lëvizjet vjetore të oficerëve të policisë gjyqësore të ngarkuar me seksionin e krimit ekonomik dhe zëvendësimit të tyre me kolegë të rinj që vijnë p.sh. nga policia rrugore, të cilët nuk janë në gjendje të japin mbështetje efektive në hetim për shkak të mungesës së ekspertizës. Në shumë raste, oficeri i sapocaktuar mund të mos ketë specializimin apo ekspertizën e nevojshme për veprën penale në fjalë, për shkak se deri në atë moment ka qenë në një drejtori që merrej me krime krejtësisht të ndryshme ose sapo është emëruar oficer i policisë gjyqësore.

Në këtë aspekt dhe me qëllim garantimitin e vazhdimësisë efektive të hetimit, u raportua se çështjet transferoheshin nga një oficer i një seksioni tek një tjetër brenda së njëjtës drejtori, kur prokurori kërkonte që oficeri të mos e dorëzonte çështjen por t'ia sillte atij/asaj. Megjithatë, kjo masë duket se ndodh me raste dhe se nuk përbën një qasje të institucionalizuar për zgjidhjen e situatës.

Për më tepër, oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve kanë nevojë për kohë për t'u specializuar për lloje specifike veprash penale ose teknika hetimi. Në këtë aspekt, prokurorët përmendën gjatë intervistës përvojat e tyre të mëparshme kur në Policinë e Shtetit kishte më shumë specializim. Perceptimi i përgjithshëm i prokurorëve është që transferimi i oficerëve me përvojë të policisë në seksione të tjera cenon "*themelet e punës së tyre*". Ajo çka është edhe më shqetësuese është tendenca për transferimin e oficerëve të policisë gjyqësore për arsye operationale në shërbime para se ata të kenë marrë nivelin e mjaftueshëm të specializimit në një drejtori tjetër, duke shkaktuar kështu humbjen e specializimit dhe duke sjellë pengesa për hetimet e çështjeve në proces.

*"Kur një OPGj ka kohë në një seksion, ai njihet me objektivat e kësaj pune dhe më pas transferohet dhe duhet të fillojë nga zero". (OPGj shërbimesh)*

Përveç kësaj, ndikime të tjera negative ka tek hetimi edhe moskomunikimi i transferimit të oficerëve të prokurorët e ngarkuar me çështjet.

*"Edhe kjo sjell vonesa, sepse duhen 2 javë që dosja të shkojë atje dhe 2 javë që të kthehet, me shënimin se edhe ai oficer nuk është më aty" (prokuror)*

Vetë oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve vunë në pah ndikimet e pakënaqshme që ka rrotacioni i tepruar. Theksi u vu në veçanti te çuarja dëm e burimeve në rastin kur oficerëve që marrin pjesë në trajnime për tema të veçanta nuk u jepet mundësia t'i zbatojnë ato që kanë mësuar, duke u transferuar me punë në fusha krejtësisht të ndryshme. U raportua gjithashtu si një nga problemet kryesore fakti që transferimet ndodhin shpesh pa verifikuar si duhet se sa vite punë ka oficeri, çfarë rezultatesh ka pasur ai/ajo në punë dhe se si ka ndikuar pozitivisht ai person në luftën kundër krimit. Ndryshe nga sa parashikohet në legjislacion, siç pretendohet nga policia gjyqësore e shërbimeve, transferimet duhet të jenë të motivuara dhe duhet të merret mendimi i OPGj-së për transferimin, të intervistuarit shprehen se në fakt kjo nuk ndodh në praktikë dhe se oficerëve nuk u jepet asnjë shpjegim se pse transferohen. Pretendohet gjithashtu se nuk ekziston asnjë procedurë ankimi ndaj vendimit të transferimit.

Policia gjyqësore e shërbimeve u shpreh e vetëdijshme për faktin që madhësia e territorit dhe numri i oficerëve të policisë në dispozicion kërkojnë një lloj fleksibiliteti. Megjithatë, ata theksuan aspektin teknik të çështjes në fjalë:

*"...puna duhet të bëhet dhe kjo mund të bëhet vetëm me njerëz të aftë profesionalisht, në mos duam që të bëjmë sikur punojmë." (OPGj shërbimesh)*

Duke e parë çështjen nga një tjetër këndvështrim, prokurorët u shprehën se ishin të vetëdijshëm që transferimi i oficerëve të policisë gjyqësore të shërbimeve përdoret shpesh si sanksion dhe se

ata janë të kujdesshëm në ndërmarrjen e masave disiplinore në rastet e një performance jo të kënaqshme të oficerëve të policisë gjyqësore të shërbimeve, pasi këto masa mund të çojnë në ndëshkime të tepruara dhe se oficeri mund të transferohet "në zonat më të largëta."

Ekziston një shqetësim i përgjithshëm që rrotacioni i shpeshtë i oficerëve të policisë gjyqësore të shërbimeve shkakton mungesë stabiliteti dhe ndikon tek besimi:

*"Pikë së pari, është problem besimi. Problem besimi për shumë arsye, sepse OPGj-të e shërbimeve ndryshojnë çdo 6 muaj, kështu që nuk ka stabilitet në këtë pozicion ... Sapo krijon besim tek OPGj-ja, e lëvizin." (prokuror)*

Mungesa e besimit si faktor që ndikon negativisht në marrëdhëniet mes policisë gjyqësore dhe prokurorëve vlerësohet i dyti nga rëndësia. Gjetjet e pyetësorëve tregojnë se oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve i kushtojnë shumë rëndësi këtij faktori si parakusht për bashkëpunimin dhe pothuajse gjysma e tyre e konsiderojnë besimin e pamjaftueshëm mes agjencive si pengesën kryesore të shkëmbimit të informacionit.<sup>32</sup>

E megjithatë, intervistat tregojnë se mungesa e besimit ndikon negativisht kryesisht në marrëdhëniet mes prokurorëve dhe policisë gjyqësore të shërbimeve. Përveç lëvizjeve të shpeshta të oficerëve, prokurorët janë të shqetësuar se puna e Policisë së Shtetit ndikohet edhe nga rrethanat politike që mund të kenë ndikim negativ:

*"Ne duhet të krijojmë njëfarë besimi, kështu që duhet të forcojmë stabilitetin dhe pavarësinë e Policisë së Shtetit. Policia e Shtetit duhet të ndahet nga Ministri i Brendshëm, në mënyrë që të kemi shefa policie që nuk emërohen nga Ministri dhe vetëm atëherë do të kemi OPGj të aftë për t'u marrë me hetimin." (prokuror)*

Si prokurorët, ashtu dhe oficerët e policisë gjyqësore janë njësoj të vetëdijshëm se mosbesimi shkaktohet shpesh nga komunikimi i pamjaftueshëm ose jo i mirë. Takimet sistematike mes prokurorëve dhe oficerëve të shërbimeve nuk janë shumë të zakonshme e madje edhe komunikimi formal në formën e shkëmbimit të shkresave ndonjëherë mungon; takime të tilla mbahen vetëm për çështjet më komplekse dhe më serioze për diskutimin e strategjisë së hetimit dhe për ndjekjen e ecurisë së tyre. Ky aspekt përbën jo kaq problem për policinë gjyqësore të seksioneve, të cilët ndihen përgjithësisht se 'kanë lidhje me të ngushta' me prokurorët.

Të pyetur rreth rëndësisë së besimit në intervista, oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve ishin më të vetëdijshëm për përfitimet që ka krijimi i marrëdhënieve të mira të punës me prokurorët, besim që krijohet përmes shkëmbimit të pikëpamjeve, punës së mirë dhe përvojës:

*"Po flas për veten time, kam qenë shumë korrekt në punë; thjesht kam respektuar ligjin. Kështu, kam krijuar besim." (OPGj seksionesh)*

Pavarësisht të kuptuarit si nga prokurorët, ashtu edhe nga policia gjyqësore se komunikimi i hapur është jetësor për krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve të mira të punës, frika nga pasojat mund ta dëmtojë këtë bashkëpunim:

*"Ka nga ata prokurorë që të kërkojnë të bësh gjëra që nuk kanë lidhje me hetimin. E kupton që e ka gabim, por nuk e kundërshton, sepse prokurori mund të marrë masa disiplinore. Kështu që duhet të biem dakord." (OPGj i seksioneve)*

Mungesa e besimit tek prokurorët çon shpesh në pamundësinë e policisë gjyqësore për të ruajtur konfidencialitetin e procedimeve penale. Pavarësisht dispozitave të qarta të legjislationit në fuqi, çështja e konfidencialitetit të hetimit duket shumë shqetësuese për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, si në raportin statistikor, ashtu edhe tek intervistat. Zinxhiri i gjatë i administrimit të dosjeve të çështjeve, sidomos në lidhje me hetimet e kryera nga shërbimet e policisë krijon hapësira për shkelje të sekretit hetimor dhe e bën të vështirë gjetjen e personit përgjegjës. Në këtë aspekt, prokurorët sollën një praktikë që vinte nga një Udhëzim i Përbashkët i vitit 2009 të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të Ministrit të Brendshëm, sipas të cilit pas regjistrimit të çështjeve në prokurori dhe hartimit të planit të hetimit dhe akteve korresponduese të delegimit të tij tek policia, dosja dërgohet me mënyrat e zakonshme "zyrtarisht" nga prokuroria në drejtorinë lokale të policisë. Në këtë mënyrë, dosja, e cila shpesh përmban informacione delikate shkon nga njëra dorë në tjetrën, duke filluar nga stafi administrativ i prokurorisë dhe më pas në zyrat e Drejtorit të Policisë, Zëvendës-drejtorit, shefit të seksionit dhe "dy javë pas datës së fillimit, dosja gjendet në duart e OPGj-së", i cili

32 Raporti Statistikor, Figura 2, Figura 200.

presupozohet të ndërmarrë aktet hetimore. Disa prokurorë u shprehën se tentativat për dorëzimin e dosjeve drejtpërdrejt tek oficerët e policisë gjyqësore nuk janë miratuar nga shefat e policisë, të cilët vlerësojnë se duhet të ndiqet protokoli standard për mundësimin e administrimit si duhet të aktiviteteteve të oficerëve (p.sh. për të kontrolluar ditët e punës dhe dietat përkatëse).

Në këtë mënyrë dhe në mungesë të një mekanizmi efikas kontrolli dhe frenimit të njerëzve që kanë akses në dosje, rreziku i shkeljes së sekretit mund të rritet në mënyrë eksponenciale. Me qëllim parandalimin e 'rrjedhjeve', disa prokurorë shprehën se i mbajnë dosjet e çështjeve në prokurori dhe thjesht i delegojnë policisë gjyqësore detyra të caktuara.

Si prokurorët, ashtu edhe policia gjyqësore duket se bien dakord për disa zgjidhje të mundshme të shkeljeve të sipërpërmendura të sekretit, të cilat do të përfshinin përdorimin e zarfeve të vulosur ose aplikimin e një procedure që mundëson dorëzimin e dosjeve direkt tek oficeri përkatës i policisë gjyqësore, gjë që duket veçanërisht e rëndësishme në hetimet delikate. Ata vlerësojnë se është e nevojshme të theksohet çështja e konfidentalitetit në çdo takim të rëndësishëm në lidhje me hetimet.

Ndonëse nevoja për aktivizimin e procedimeve disiplinore për rastet e shkeljeve të konfidentalitetit nuk u përmend shprehimisht gjatë intervistave, mundësia e procedimeve penale kundër personave përgjegjës për rrjedhjet në fjalë u përmend dhe u sugjerua qartë nga oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve.

Përveç kësaj, prokurorët theksojnë se ndodh shumë shpesh që kallëzimet për vepra të mundshme penale që dorëzohen në polici të dalin në media përpara se të njihet me to prokuroria, gjë që ka pasoja të dëmshme për hetimin dhe për perceptimin publik të efikasitetit. Ky shqetësim u shpreh veçanërisht në lidhje me publikimin e transkriptimeve të përgjimeve. Kjo jo vetëm vë në rrezik hetimin zyrtar, por nxit edhe presione të panevojshme mbi prokurorët, kryesisht në çështjet ku zyrtarët e institucioneve publike përpiqen të ndërhyjnë në prokurori pasi njihen me *notitia criminis* nga media. Përveç kësaj, prokurorët shprehën shqetësimin se ndihen të detyruar t'i përmbahen një procesi të caktuar (p.sh. në lidhje me arrestimet) pas mbulimit mediatik për të shmangur supozimet për praktikat korruptive mes publikut të gjera:

*"... dhe pastaj jemi në të këqijtë që lirojmë të arrestuarit ... unë mendoj që mund ta lë një person të lirë, por nuk e bëj, sepse do thonë se mora para për ta liruar. Kështu që e mbaj brenda."(prokuror)*

Përveç rasteve individuale, ku hetimi mund të pengohet qëllimisht dhe mund t'i përkasë çfarëdolloj agjencie shtetërore të përfshirë në proces, prokurorët shohin si shkak të mundshëm për ekspozimin e hetimeve në media edhe nevojën e autoriteteve të zbatimit të ligjit për ta promovuar punën e tyre me qëllim kapërcimin e mosbesimit të publikut dhe afrimin me qytetarët.

Marrëdhëniet mes prokurorëve dhe policisë gjyqësore varen shumë nga cilësia e punës së secilës kategori profesionale. Performanca jo aq e mirë e policisë duket se përbën faktorin e dytë më të rëndësishëm për prokurorët, që ndikon negativisht në marrëdhëniet me policinë gjyqësore, ku shqetësimin më të madh e kanë shprehur prokurorët e Prokurorisë së Krimeve të Rënda.<sup>33</sup> Performanca jo aq e mirë e prokurorëve, nga ana tjetër, nuk duket se është aq e rëndësishme për policinë gjyqësore, sidomos atë të shërbimeve.<sup>34</sup>

Pyetësorët dhe intervistat tregojnë se faktorët kryesorë që ndikojnë në cilësinë e punës së policisë gjyqësore në hetimet penale janë mungesa e personelit të mjaftueshëm, fakti që oficerët e policisë së Shtetit kryejnë detyra hetimore bashkë me detyra administrative dhe detyra të tjera në zbatim të ligjit, që çon në mbingarkesë të tyre. Standardet dhe metodat e rekrutimit të oficerëve të policisë gjyqësore nuk ofrojnë persona me aftësitë e nevojshme profesionale dhe, si rrjedhojë, shumë oficerëve të policisë gjyqësore u mungojnë aftësitë hetimore.<sup>35</sup>

Një çështje ku si prokurorët, ashtu edhe policia gjyqësore dukeshin se binin dakord në intervista, si dhe mes tyre dhe gjetjeve të pyetësorëve ishte mbingarkesa e oficerëve të policisë së shërbimeve.

Varësia e dyfishtë e oficerëve të policisë së shërbimeve kërkon që ata të merren me detyrat hetimore që u caktojnë prokurorët dhe me detyra administrative të zbatimit të ligjit që u ngarkojnë shefat e drejtorive përkatëse të policisë. Këto funksione ushtrohen në një kontekst të karakterizuar

33 Raporti Statistikor, Figura 3.

34 Raporti Statistikor, Figura 2.

35 Raporti Statistikor, Figura 4.

nga një numër i kufizuar oficerësh policie të shpërndarë në mënyrë të pabarabartë në njësitë e drejtorive, si dhe nga një shpërndarje e pabarabartë e ngarkesës së punës mes njësite të ndryshme, pjesa më e madhe e të cilave thuhet se u caktohet më pak se gjysmës së oficerëve.

Si oficerët e policisë, ashtu edhe prokurorët bien dakord se sa herë që dinamika e drejtorive të policisë kërkon fokusim në aspektet operacionale të punës së policisë (p.sh. kontrollat për drogë, pikat e kontrollit, ndërhyrjet e fokusuara tek ndërtimet pa leje, etj.) ose kryerje të detyrave raportuese, koha që u kushtohet këtyre detyrave dhe cilësia e hetimeve penale të ngarkuara nga prokurorët kanë probleme. Nuk është e pazakontë që prioritetet e zbatimit të ligjit, domethënë "fushatat e fokusuara" të vendosen mbi punën hetimore dhe atëherë policia gjyqësore 'të lërë gjithçka tjetër'. U raportuan gjithashtu raste kur prokurorëve u kërkohet që t'ua delegojnë veprimet hetimore oficerëve të tjerë dhe jo atij që ka marrë kallëzimin fillestar për shkak të mbingarkesës së punës.

Prokurorët vlerësojnë se duhet të bëhet një ndarje e qartë e funksioneve për oficerët e policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit për ta zgjidhur këtë situatë.

*"Kjo ndarje do të ishte saktësisht mënyra e strukturimit të hetimeve me varësi të drejtpërdrejtë nga organet procedurale që drejtojnë hetimin me mbështetjen që u duhet për ndërmarrjen e hetimit. Vetëm tani mund të flasim për hetim si duhet. Sepse OPGj-të e shërbimeve merren edhe me detyra të tjera dhe nuk fokusohen tek hetimi." (prokuror)*

Ajo çka rezulton nga ky konstatim është nevoja për të parë mundësinë e ndarjes mes detyrave hetimore nga ato për zbatimin e ligjit me qëllim garantimin e një koordinimi më efikas me prokurorët dhe një cilësi më të mirë të hetimit.<sup>36</sup>

Mbingarkesa në punë duket shpesh e lidhur me mungesën e një numri të mjaftueshëm oficerësh policie të kualifikuar në shërbimet e policisë. Përveç kësaj, mosrekrutimi i personelit të mjaftueshëm shihet nga prokurorët si problem jo vetëm për shërbimet në Policinë e Shtetit, por edhe për zyrtarë të tjerë qeveritarë që kanë funksionet e policisë gjyqësore.

Në pyetësorë nuk bëhet dallimi në përgjigje në lidhje me performancën jo të mirë sa duhet mes policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve. Prandaj, janë marrë parasysh pikëpamjet e prokurorëve të intervistuar për cilësinë e punës së oficerëve të policisë së seksioneve.

Një problem që u ndesh përgjithësisht gjatë intervistave është mungesa e përvojës së duhur të oficerëve të policisë për shkak të moshës së tyre relativisht të re. Ky problem u theksua veçanërisht nga vetë oficerët e policisë sa u përket gradave:

*"Në Policinë e Shtetit ka shumë oficerë policie të rinj në moshë që nuk e kanë përvojën e nevojshme për t'u marrë me hetime të thelluara dhe ky është problemi kryesor që has prokuroria me policinë në momentin e delegimit të veprimeve." (OPGj shërbime)*

Në cilësinë e hetimeve ndikon negativisht mungesa e njohjes së procedurave dhe e aftësive bazë të hetimit. Prokurorët pranojnë se të paktë janë oficerët që janë të njohur me ndryshimet e kodit procedural të vitit 2017. Problemi më i madh duket pamundësia për ndjekjen e rregullave procedurale për mbledhjen e provave për garantimin e pranueshmërisë së tyre në gjykatë, p.sh. prania e avokatit mbrojtës në intervistimin e të dyshuarve. Ajo çka duket si një shqetësim i përbashkët është që shumë oficerë të policisë së shërbimeve nuk njohin elementët e veprave penale, gjë që ndikon më pas në aftësinë e tyre për marrjen e provave të rëndësishme në kryerjen, p.sh., të intervistave të thelluara me dëshmitarët. U raportua se ndonjëherë prokurorët u japin oficerëve, të cilëve iu delegojnë hetimin, edhe pyetjet që duhet të bëjnë.

Në disa raste, oficerët nuk koordinohen për punën brenda të njëjtit hetim, gjë që çon në përgatitjen e raporteve kontradiktore.

Sipas prokurorëve, njohja e aspekteve procedurale të punës dhe ekspertiza në lidhje me lloje të caktuara krimesh, p.sh., krimin ekonomik, u lejon oficerëve të seksioneve t'i kryejnë hetimet në mënyrë të pavarur. Në përgjithësi, seksionet janë më pak të prekur nga qarkullimi i stafit, pra 'më të qëndrueshëm', gjë që u ka lejuar prokurorëve të mësohen me metodat e punës së njëri-tjetrit dhe të japin 'shumë pak shpjegime'.

Arsyet kryesore që shkaktojnë shqetësimet e prokurorëve për cilësinë e punës së policisë gjyqësore

36 Shih gjithashtu nënseksionin 2.2.1



të seksioneve është vendi i tyre sistematik, që përgjithësisht besohet se çon në 'mungesën e infra-strukturës', që i shkëput ata nga aspektet operative të punës. Siç u shpreh një prokuror: "Ata nuk janë në terren dhe nuk e kuptojnë terrenin".

Mungesa e njohjes nga disa prokurorë e detajeve të punës hetimore konsiderohet veçanërisht si një faktor që ndikon negativisht në performancën e tyre: "Problemi është se prokurorët sot nuk e njohin terrenin. Nuk dalin nga zyra." Kjo u konfirmua qartësisht edhe nga konstatimet e Raportit Statistikor, i cili tregon se më pak se një e treta e prokurorëve i kryejnë shpesh vetë veprimet hetimore dhe se, nëse e bëjnë këtë, ato konsistojnë kryesisht në intervista.<sup>37</sup> Duket se prokurorët angazhohen personalisht për kryerjen e aktiviteteve hetimore kryesisht për çështje delikate, p.sh. çështje që përfshijnë persona shumë të njohur ose që kanë mbulime të mëdha në media. Megjithatë, duket se arsyeja kryesore për këtë është ngarkesa e punës, e cila nuk i lejon prokurorët të marrin pjesë aktive në hetime, përveçse të urdhërojnë apo delegojnë policinë.

Vetë prokurorët janë të shqetësuar se mungesa e një stafi të mjaftueshëm mbështetës dhe ndihmës krijon një tjetër barrë, pasi ata janë shpesh të zënë me çështje teknike, p.sh. me fotokopjime ose me krijimin e dosjes dhe nuk kanë mundësi të fokusohen në detyrat e tyre thelbësore.

Ndonëse performanca jo e mirë sa duhet shihet si pengesa kryesore për bashkëpunimin efikas mes policisë gjyqësore dhe prokurorëve, nevoja për hetime cilësore është diçka për të cilën të gjithë bien dakord.

Mungesa e qëllimeve të përbashkëta në procedurat penale konsiderohet problem serioz për vendosjen e një bashkëpunimi të mirë mes prokurorëve dhe policisë gjyqësore. Ndonëse pyetësi tregon se ky faktor është njësoj i rëndësishëm për OPGj-të e shërbimeve, OPGj-të e seksioneve dhe prokurorët, secila prej këtyre kategorive profesionale shpreh shqetësime të ndryshme për këtë çështje gjatë intervistave.

Të qenit pjesë e prokurorisë u jep OPGj-ve të njëjtat prioritete, vlera dhe qëndrime si prokurorët dhe i bën ata të ndihen si një ekip, gjë që mbështetet edhe nga prokurorët. Megjithatë, kur vjen fjala tek oficerët e shërbimeve, prokurorët janë të shqetësuar se rrallë ndihet që të kenë të njëjtat qëllime dhe se nuk ekziston një "unitet organik". Shkaqet për këtë nuk janë vetëm strukturore, por edhe të rrënjosura në prioritetet e ndryshme të OPGj-ve të shërbimeve, si p.sh. në kriteret e matjes dhe vlerësimit të punës së policisë, e cila është kryesisht sasiore:

*"OPGj-të janë shumë formalë. Qëllimi i OPGj-ve nuk duket se është zgjidhja e çështjeve. Ata punojnë më shumë për statistika sesa për zgjidhjen e çështjeve, duke qenë se ajo që u intereson është se sa arrestime në flagrancë kanë bërë.... Ndonjëherë dalin në përfundime të gabuara ndonëse, p.sh., mund të mos kenë prova, thonë 'Ta çojmë në gjykatë'. Po punojmë si në kohën e Enver Hoxhës me statistikat." (prokuror)*

Ajo çka duket të jetë një tjetër shqetësim është niveli i pamjaftueshëm i bashkëpunimit mes oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve. Nga pikëpamja institucionale, që të dyja kategoritë e policisë gjyqësore raportojnë direkt dhe veçmas tek prokurori i çështjes në bazë të një shkresë delegimi të hetimit që u caktohet. Nga pikëpamja organizative, ndonëse përshkruhen përgjithësisht si "reagues" dhe të mirë, si përmes kanaleve zyrtare të komunikimit dhe në nivel personal, bashkëpunimi duket se kufizohet tek koordinimi i "punëve të caktuara" si mbledhja e informacioneve nga njerëzit, gjetja dhe verifikimi i adresave të caktuara, etj., dhe sqarimi me raste i çështjeve procedurale ose çështjeve ku u kërkohet të punojnë bashkërisht.

Të pyetur nëse ka bashkëpunim sistematik dhe mbështetje reciproke gjatë kryerjes së hetimeve, të paktën në momentin e këshillimit të prokurorit për cilësimet e mundshme të një veprë të caktuar penale, si oficerët e seksioneve, ashtu edhe ata të shërbimeve ranë dakord se puna hetimore nuk i lidh shumë.

*"Jo, ne nuk merremi me ta, se dhe ata nuk merren me ne" (OPGj shërbimesh dhe OPGj seksionesh)*

Ndonëse situata e përshkruar hedh dyshime mbi përdorimin strategjik, racional dhe eficient të burimeve njerëzore hetimore në dispozicion të prokurorëve, duke gjithashtu se ajo ndikon në rezultatet e suksesshme të hapave të caktuar hetimorë kur - siç raportohet gjatë intervistave - përpunimi i dosjes së çështjes nga oficerët gjyqësorë të seksioneve tregon se duhet të ishin ndërmarrë hapa

37 Raporti Statistikor, Figura 22-23.

urgjent që në fillim të hetimit, hapa që nuk janë marrë dhe që nuk mund të përsëriten në një fazë të mëvonshme. Duket se nevojiten përpjekje të tjera për kapërcimin e perceptimit aktual që oficerët e seksioneve dhe të shërbimeve nuk kanë një vizion dhe koncept të përbashkët, se janë që të gjithë pjesë e përpjekjeve të përbashkëta hetimore me synim arritjen e qëllimeve të përbashkëta.

Pyetësi tregon se të intervistuarit në përgjithësi pranojnë se ndërhyrjet politike ndikojnë negativisht në marrëdhëniet midis tyre, por preferojnë t'i kushtojnë më pak rëndësi këtij faktori, duke e vendosur atë në fund të listës së elementëve të rëndësishëm për bashkëpunimin mes prokurorëve dhe policisë gjyqësore.<sup>38</sup> Prokurorët pranojnë se për ta ndërhyrjet politike shprehen më së shumti nga tentativat për ndikim në rastet e çështjeve të njohura, si çështjet kundër personave që mbajnë funksione të rëndësishme apo rastet e korrupsionit.

*"Prokurorët janë në gjendje të punojnë në mënyrë të pavarur në shumicën e rasteve, por nuk mund të themi se janë të izoluar nga realiteti përreth."(prokuror)*

Përveç asaj që shihet tashmë sa i përket sekretit të hetimit dhe masave për zgjidhje në rastin e raporteve të pakënaqshme, prokurorët kanë hasur raste inspektorësh, që u janë dërguar pas kërkesave të policisë dërguar Ministrisë së Drejtësisë, akuza për demotivim të policisë për shkak të vendimeve për shpalljen të pavlefshme të arrestimeve apo akteve të caktuara, si dhe raste presionesh që perceptohen se kanë ardhur nga kërkesat për informim mbi zhvillimin e çështjeve individuale nga organizatat vendase, ndërkombëtare dhe nga agjenci të ndryshme.

Gjatë intervistave, prokurorët shprehën shqetësime se lëvizjet apo pushimet nga puna të oficerëve të policisë gjyqësore të shërbimeve vijnë shpesh nga ndërhyrjet politike: "Kemi pasur kontakte me OPGJ që kanë qenë shumë të përgatitur dhe që më pas janë hequr për arsye politike". Policia gjyqësore e shërbimeve vlerëson gjithashtu se ndërhyrjet nga eprorët janë forma më e konsiderueshme e ndikimeve politike mbi ta.

Prokurorët besojnë se i japin gjithmonë policisë gjyqësore mbështetjen profesionale dhe interpretimin e dispozitave të së drejtës penale. Megjithatë, në perceptimin e oficerëve të policisë, si të seksioneve, ashtu edhe të shërbimeve, ndihma me interpretimet ligjore<sup>39</sup> u jepet vetëm në rastet, kur prokurorët e gjykojnë të nevojshme.<sup>40</sup> Në shumicën e rasteve, kjo ndodh në momentin kur nevojitet shtyrja e afatit të hetimit ose në momentin e regjistrimit dhe vlerësimit të kallëzimit të veprës penale, përgatitjes së intervistave apo përfundimit të hetimit, si dhe pas paraqitjes së relacionit shpjegues nga policia. Zhvillimi i takimeve të përbashkëta me prokurorët për diskutimin e ndryshimeve të rëndësishme në legjislacion që prekin punën e tyre u përmend si praktikë e mirë nga oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve.

Shumë të intervistuar janë të mendimit se burimet ekzistuese njerëzore dhe teknike nuk janë të mjaftueshme për përballimin e ngarkesës aktuale, sidomos në hetimet e korrupsionit.<sup>41</sup> Kjo çështje është veçanërisht urgjente për oficerët e seksioneve që mendojnë se Ligji për Policinë Gjyqësore nuk garanton sa duhet disponueshmërinë e këtyre burimeve.<sup>42</sup> Në praktikë, oficerët e seksioneve konstatojnë se pavarësisht se shumë burime ekzistojnë online, për ta përbën problem serioz prokurimi i literaturës së specializuar dhe kodeve me paratë e veta ose fakti që kanë vetëm libra dhe komentare të vjetruar. Në disa raste, oficerët e seksioneve dhe të shërbimeve shprehën shqetësime për mungesën e automjeteve të shërbimit: "Nuk kemi makina as për të shkuar në vendngjarje. Shkojmë me makinat tona".

## 4.2 Rolet gjatë hetimeve

Ky seksion i Raportit trajton perceptimet e prokurorëve dhe policisë gjyqësore të ndikimit që kanë pasur ndryshimet e fundit në legjislacion në ndërveprimin e tyre. Së dyti, ai shtjellon mënyrat se si u

38 Raporti Statistikor, Figura 2

39 Raporti statistikor, Figura 83: oficerët e policisë gjyqësore janë përgjithësisht të bindur se i njohin kërkesat ligjore për mbledhjen e provave me qëllim garantimin e pranueshmërisë së tyre në gjykatë (94% e policisë së seksioneve dhe 85% e policisë së shërbimeve), por nuk kanë të njëjtin mendim prokurorët (vetëm 24% e tyre iu përgjigjën pozitivisht kësaj pyetjeje).

40 Raporti Statistikor, Figura 43.

41 Raporti Statistikor, Figura 243.

42 Raporti Statistikor, Figura 47.

caktohen hetimet oficerëve të policisë së shërbimeve dhe seksioneve dhe rëndësinë e aftësive dhe njohurive specifike në këtë aspekt. Në fund, ai synon të vlerësojë nëse mungesa e aftësive të tilla tek oficerët e policisë gjyqësore ndikon në vendimin e prokurorëve për t'ia caktuar çështjen një oficeri tjetër për të garantuar ndjekjen si duhet të saj. Çështjet që kanë të bëjnë me rolin e prokurorëve në hetime parashtrohen në seksionin 4.3 të këtij Raporti, i cili merret me rolin drejtues të prokurorisë.

Prokurorët dhe policia gjyqësore ndihen se ndryshimet e fundit në ligjin procedural nuk kanë ndikuar ndjeshëm në ndërveprimin mes tyre. Prokurorët janë më të bindur për këtë sesa oficerët e policisë gjyqësore, por janë shumë të paktë në përgjithësi ata që mendojnë se këto ndryshime kanë pasur ndikime negative.<sup>43</sup> Për më tepër, të dhënat statistikore tregojnë se prokurorët dhe policia gjyqësore në përgjithësi janë të bindur se rolet e tyre janë të përcaktuara qartësisht me ligj.<sup>44</sup> Intervistat e kryera për përgatitjen e këtij raporti dhanë mundësinë për të parë më nga afër perceptimet e prokurorëve dhe policisë gjyqësore dhe për të marrë mendimet e tyre mbi nevojën e rivlerësimit të rolit të policisë gjyqësore të seksioneve. Ndonëse aftësitë dhe njohuritë e këtyre të fundit, janë të padiskutueshme, disa prokurorë mendojnë se oficerët e policisë së seksioneve mund të shfrytëzohen shumë më mirë nëse sistemi aktual reformohet dhe nëse oficerëve të seksioneve u jepet roli i këshilltarëve të prokurorëve, duke marrë disa prej përgjegjësi të prokurorëve në përgatitjen e akteve procedurale. Kjo qasje do të lejonte nga njëra anë kapërcimin e problemit funksional në lidhje me mungesën e burimeve operationale ("*ata janë jashtë terrenit*"), do të sillte shfrytëzimin më të mirë të ekspertizës së tyre dhe do të përforconte në mënyrë efikase prokuroritë. Në këtë linjë, prokurorët shohin nevojën e "*ndryshimeve të shpejta të ligjit, duke e lënë prokurorinë vetëm me prokurorë dhe këshilltarë*" dhe *hetimin në duart e policisë së shtetit, që është profesionale dhe jo politike*". Edhe policia e seksioneve i sheh ndryshimet e fundit si më pak të favorshme dhe mendon se rregullat e reja kanë ndikuar negativisht në motivimin e tyre. Shqetësimet lidhen kryesisht me mundësitë e kufizuara për karrierë dhe pagë (d.m.th. pagat dhe kompensimet për orët jashtë orarit).

Sa u përket ndryshimeve legislative, ndonëse modalitetet e konsultimeve gjatë procesit legjislativ nuk ishin objekt i drejtpërdrejtë i pyetjeve, u vu re në mënyrë të rastësishme se tre të intervistuar u ankuan se nuk kanë qenë të përfshirë si duhet në fazën e hartimit të legjislacionit të ri apo ndryshimeve në legjislacionin aktual.

Disa prokurori u shprehën se u ishte dhënë vetëm 2 ditë kohë për të dhënë komente për ndryshimet e kodit të procedurave në vitin 2017, duke e kthyer konsultimin thjesht në një formalitet. Për konsultime të pamjaftueshme dhe joefikase për Ligjin e ri për Policinë Gjyqësore u ankuan si prokurorët, ashtu edhe OPG-jtë gjatë intervistave.

Sa i përket rolit të policisë gjyqësore në hetime, gjatë intervistave u bënë shumë komente për nevojën e forcimit të aspektit hetimor të punës dhe për reduktimin e barrës që vjen nga funksionet e shumëfishta administrative dhe parandaluese. Për këtë çështje jepen më shumë hollësi në seksionin 4.1 Çështje të Përgjithshme/Cilësia e punës.

Kuadri ligjor aktual që përcakton kriteret për kryerjen e hetimeve nga policia gjyqësore e shërbimeve dhe e seksioneve çon në interpretime të ndryshme nga prokurorët, të bazuara më shumë në rrethanat praktike sesa ato ligjore. Ajo çka del nga intervistat është se prokurorët në përgjithësi tentojnë të ndjekin "*rregullin bazë*" të delegimit të hetimeve tek oficerët që kanë dorëzuar referimin. Kjo ka avantazhin se oficeri është ndërkohë i njohur me çështjen. Pavarësisht kësaj, ndonjëherë organizimi i brendshëm i policisë krijon mundësi që me të njëjtën çështje të ngarkohen edhe oficerë të tjerë, gjë që çon në rezultate jo konsistente.

*"Unë jam i prirur t'ia dërgoj të njëjtit person, sepse ai e ka më të qartë kuadrin ligjor. Megjithatë, nga mënyra se si janë të organizuara stacionet e policisë tani, mund të ndodhë që në të njëjtën çështje të angazhohen 3-4 oficerë dhe kjo është shumë gabim, sepse njëri shënon shpjegime që tjetri nuk i shënon dhe unë kam hasur shpjegime kontradiktore në dosje, sepse ata kanë stile të ndryshme të të bërit të pyetjeve, të cilat mund të thellohen ose jo. Kështu që rezultatet mund të jenë të ndryshme për të njëjtën çështje thjesht ngaqë dëshmitarët, p.sh., janë marrë në pyetje nga dy oficerë të ndryshëm"* (prokuror)

Në disa raste, prokurorët shohin mundësinë e delegimit të çështjeve tek policia gjyqësore e shërbimeve – ose për shkak të afërsisë ose për shkak se ata duken më të përgatitur: "*Unë përipiqem të zgjedh ata që punojnë më shumë dhe që mund ta çojnë çështjen përpara, por oficerë të tillë janë të paktë*".

43 Raporti Statistikor, Figura 13.

44 Raporti Statistikor, Figura 40.

Intervistat konfirmojnë se prokurorët i njohin mirë të drejtat e tyre për t'i ricaktuar hetimet, por në realitet kjo ndodh më shpesh për shkak të transferimit të oficerëve të shërbimeve. Për të thjeshtuar shkëmbimin e materialeve dhe për të shkurtuar kohën e hetimit, sidomos në hetimet më të vështira, prokurorët zgjedhin shpesh t'ua delegojnë çështjet që nga fillimi i hetimit oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve, duke rritur kështu ngarkesën e tyre.

Për shkak të natyrës së fragmentuar të strukturave hetimore dhe opinioneve të shumta për mungesën e koordinimit midis (i) shërbimeve të agjencive të ndryshme dhe (ii) mes shërbimeve dhe seksioneve, prokurorët mbrojnë fort idenë se i njëjti oficer duhet ta ndjekë një çështje nga fillimi deri në fund, edhe në qoftë se veprime të veçuara i delegohen jashtë fushës së tij/saj. Mes shumë përfitimeve që mund të sjellë kjo qasje janë konsistenca, shpejtësia dhe mosndërprerja e "*pasionit dhe angazhimit*".

Çështja e diskrecionit të policisë gjyqësore në kryerjen e akteve hetimore është çështja më e paqartë për shkak të mospërputhjes së rezultateve që dalin nga pyetësori dhe nga intervistat.

Gjatë intervistave, të intervistuarit nga të trija kategoritë u duk se binin dakord se oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve gëzojnë dhe ushtrojnë nivelin e nevojshëm të diskrecionit dhe iniciativës në zbatimin e akteve të delegimit të hetimeve nga prokurori, si duke zgjeruar objektin e akteve të besuara, ashtu edhe duke identifikuar pista të reja hetimi. Diskrecioni ushtrohet rast pas rasti, ku bashkëpunimi me prokurorin mund të jetë në disa raste më i afërt (p.sh. njoftime të mëparshme për prokurorin dhe/ose ruajtja e një kanali aktiv komunikimi me ta).

Megjithatë, numri më i madh i të intervistuarve në këtë sondazh përmes pyetësorëve u dukën shumë më pak të sigurt për shkallën e këtij diskrecioni. Në mënyrë specifike, oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve dhe seksioneve pranojnë mundësinë për kryerjen e hetimeve me nismën e tyre "për hir të hetimit dhe pa shkelur ligjin". Megjithatë, në kontekstin e roleve përkatëse në hetim dhe ndërveprimin e tyre me prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve duket se i kushtojnë më shumë rëndësi kufizimeve të diskrecionit të tyre.<sup>45</sup> Përfundimet e pyetësorit treguan gjithashtu se oficerët e seksioneve janë shumë më të shqetësuar që u jepet jo shumë diskrecion, gjë që çon në mungesën e fleksibilitetit të hetimeve të policisë.<sup>46</sup>

## 4.3 Roli drejtues

*"Roli i prokurorit është të orientojë dhe të kontrollojë. Kjo është gjithçka që ata bëjnë. Ne jemi nën drejtimin e tyre." (OPGj seksionesh)*

Pyetësori tregon përgjigje dërrmuese pozitive nga prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve që e kanë të qartë rolin drejtues të prokurorit në hetimet penale.<sup>47</sup> Kur vjen fjala tek të kuptuarit e përgjithshëm të asaj çka përbën rolin drejtues aktual, dalin këto katër karakteristika: (i) kontrolli i hetimeve paraprake; (ii) marrja e vendimeve për cilësimet ligjore të veprave penale; (iii) menaxhimi dhe mbikëqyrja e policisë gjyqësore përmes urdhrave, udhëzimeve dhe delegimit të veprimeve hetimore; dhe (iv) vendimeve nëse çështjet duhen çuar në gjykatë. Këto janë aspekte që lidhen me funksionin profesional të prokurorëve sipas përcaktimeve në ligj dhe të intervistuarit në këtë sondazh u shprehën se nuk ka mospërputhje në mënyrën se si këto funksione ushtrohen aktualisht dhe se si duhet të jenë në kushte ideale.<sup>48</sup>

Megjithatë, kur vjen fjala tek karakteristikat që lidhen me kompetencat profesionale të prokurorëve, si integriteti, respektimi i diversitetit, komunikimi, llogaridhënia, roli drejtues, menaxhimi i performancës dhe krijimi i vlerësimit, vihen re mospërputhje të konsiderueshme<sup>49</sup> midis mënyrës se si shfaqen aktualisht këto karakteristika dhe se si duhet të shfaqen ato.<sup>50</sup>

45 Raporti Statistikor, Figura 2

46 Raporti Statistikor, Figura 63.

47 Raporti Statistikor, Figura 57.

48 Raporti Statistikor, Figura 49.

49 Për qëllimet analitike, iu kushtua vëmendje këtyre kompetencave, për të cilat ka më shumë se 10% ndryshim në përgjigjet totale midis "Duhet të jetë" dhe "Është aktualisht", siç tregohet në Fig. 49 dhe Fig. 50 të këtij sondazhi.

50 ibid

Megjithatë, rezultat e intervistave tregojnë se mënyra se si kuptohet nocioni i rolit drejtues i prokurorisë në hetime duket se është më shumë formaliste, gjë që duket nga gjuha përshtuese e kodit procedural. Ajo çka nuk përbën habi është që një në çdo tre të intervistuar konstaton se nuk ka rol drejtues në realitet, sepse prokurorët kryesisht japin udhëzime të përgjithshme dhe ushtrojnë një mbikëqyrje të përgjithshme.<sup>51</sup> Që të gjithë të intervistuarit iu referuan dispozitave të kodit si provë objektive që roli drejtues i prokurorisë ka është ende në fuqi. Gjatë intervistave nuk u vu re shumë reflektim për aspektet shumëplanëshe të zbatimit praktik të këtij roli drejtues.

Intervistat konfirmojnë vëzhgimin se prokurorët hasin vështirësi të konsiderueshme në pranimin, të kuptuarin dhe ushtrimin e rolit të tyre drejtues. Vetë prokurorët shprehën shqetësim se roli i tyre drejtues është shumë formal dhe se nuk shkon deri në të pasurit i një roli aktiv në hetimet penale:

*"Përgjithësisht 40% e prokurorëve nuk e kanë kuptuar filozofinë e së drejtës procedurale. Ata ende mendojnë se duhet të qëndrojnë në zyrë dhe të presin që materialet t'u vijnë aty." (prokuror)*

Mënyra se si kuptohet nocioni i rolit drejtues duket se varet nga roli që të intervistuarit u japin (ose që besojnë se legjislatori u jep) prokurorëve. Disa prokurorë shprehën se policia (duke iu referuar specifikisht policisë gjyqësore të shërbimeve) nuk ka nevojë për urdhër nga prokurori për të hetuar, sepse janë ata që i informojnë prokurorët dhe prokurorët ndërhyjnë në hetime nëse informohen nga policia.

Këtë mendim kanë edhe disa prokurorë që, pavarësisht faktit se kanë marrë parasysh raportimet e medias mbi vepra të mundshme penale, ata mendojnë se është detyrë e policisë gjyqësore të marrë iniciativën.

Disa prokurorë shkojnë edhe më tutje duke e identifikuar rolin drejtues me një formë "mbikëqyrjeje" të hetimit nga pikëpamja procedurale dhe e të drejtave të njeriut, ndërkohë që besojnë se roli i tyre më i rëndësishëm është që t'i çojnë çështjet në gjykatë dhe t'i mbrojnë ato.

Nisja e fazës hetimore para se çështja të shkojë zyrtarisht në prokurori për t'u regjistruar dhe për fillimin e hetimeve formale, përshkruhet më së miri nga oficerët e policisë së shërbimeve:

*"... ne veprojnë kështu. Me të mbledhur informacionin, kur mendojmë se e kemi përfunduar plotësisht hetimin deri në pikën e verifikimit me prokurorin, konsultohemi me shefin e seksionit në prokurori dhe bëjmë një analizë të materialeve që kemi dhe në momentin që mendojmë se ekzistojnë elementë të veprës penale, ia referojmë materialin prokurorisë. Në momentin që çështja regjistrohet si procedim, e dimë se ku duam të shkojmë me atë çështje dhe pasi prokurori cakton çështjen, hartojmë strategjinë e hetimit. Më pas, informacioni mblidhet përmes hetimit. Së bashku, vlerësojmë informacionet që kemi. Kështu që, prokurori është i përfshirë në të gjithë ecurinë e çështjes." (OPGj shërbimesh)*

Megjithatë, kur vjen fjala te pjesëmarrja aktive në fazën hetimore, si oficerët e seksioneve, ashtu edhe ata të shërbimeve duket se bien dakord se ngarkesa e punës e prokurorëve së bashku me angazhimet në seancat paraprake të gjykimit e kufizojnë ndërhyrjen në prokurorëve në çështjet më të rëndësishme apo më të larta (p.sh., në çështjet e krimit të organizuar). Edhe prokurorët janë njësoj të shqetësuar për faktorë si ngarkesa e punës<sup>52</sup>, kombinuar me mungesën e mbështetjes së mjaftueshme administrative dhe protokolleve efiçente që ua zhvendosin vëmendjen nga funksioni i tyre thelbësor:

*"Nuk e di nëse do të vijë ajo ditë që unë si prokuror të kisha vërtet pozicionin e prokurorit. Deri më sot, e kam parë veten në pozicionin e sekretares, korrierit, OPGj-së dhe vetëm pas këtyre, në pozicionin e prokurorit. Unë duhet të hartoj dokumente, t'ia dërgoj protokollit ose gjykatës dhe kjo për mua është humbje kohe dhe nuk më lejon të merrem me drejtimin dhe kontrollin e hetimeve." (prokuror)*

Në hetimet komplekse, prokurorët duket se janë më të përfshirë në ndjekjen e ecurisë së hetimeve (p.sh., në diskutimet me policinë se si mund të mblidhen sa më mirë provat) dhe në pjesëmarrjen në skenën e krimit nëse është e nevojshme.<sup>53</sup> Duhet theksuar se edhe në çështjet shumë të njohura, si p.sh. në hetimin e veprave penale të korrupsionit, qasja është më shumë pasive dhe çështjet hapen

51 Raporti Statistikor, Figura 63.

52 Raporti Statistikor, Figura 57.

53 Në total, raportohen rezultate më të larta nga prokurorët se sa nga OPGj-të në lidhje me pjesëmarrjen e prokurorëve në skenat e krimit: Raporti Statistikor, Figura 120.

me marrjen e kallëzimit penal, ndërkohë që mundësitë për të iniciuar mbledhjen e informacioneve të inteligjencës për diktimin e skemave korruptive nuk duket se përdoren sa duhet.<sup>54</sup>

Sa u përket specifikisht burimeve të informacioneve që çojnë në fillimin proaktiv të veprave penale të korrupsionit dhe që konfirmohen si nga të dhënat statistikore, ashtu edhe nga intervistat, duket se media dhe interneti janë dy burimet që përmenden më shpesh për aktivitetet kriminale.<sup>55</sup> Në raste të tjera, prokurorët mbledhin informacione nga autoritetet tatimore ose nga Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF), megjithatë pyetësi nuk mundëson vlerësimin se sa informacione ofrohen si referime dhe sa prej tyre kërkohen me nismën e vetë prokurorëve.<sup>56</sup>

Në rastet e veprave penale më pak të rënda, roli drejtues i prokurorëve duket se shoqërohet me lëshimin e urdhrave për të cilët kërkohet ndërhyrja e domosdoshme e prokurorit sipas kodit procedural, përmes dhënies së këshillave sipas rastit dhe marrjes së raporteve përfundimtare pas përfundimit të hetimit.

*"Gjithë-gjithë, na japin detyrat dhe thonë 'shihemi për tre muaj'". (OPGj në shërbime)*

E megjithatë, përveç dallimit formal nisur nga shkalla e veprës penale, disa oficerë policie folën nga njëra anë për qëndrime të disa prokurorëve "burrokratë" dhe qëndrimin "praktik" të disa të tjerëve, ku të parët ndihen më komodë me ndjekjen e hetimit nga zyra dhe që, për këtë arsye, kanë nevojë ta "përmirësojnë" metodën e tyre, kurse të dytët marrin pjesë aktive në hetime për ta paraqitur më mirë çështjen në gjykatë.

## 4.4 Zinxhiri i Komandës

*"Çdo veprim monitorohet nga eprori direkt dhe nga prokurori. Kështu që, në këtë mënyrë preket rruga e besimit dhe efijencës." (OPGj shërbime)*

Varësia e dyfishtë e policisë gjyqësore të shërbimeve nga prokurorët dhe nga administrata e policisë ka dalë si një problem kyç për bashkëpunimin mes këtyre agjencive, si në pyetësorë, ashtu edhe në intervista. Përveç asaj çka është raportuar në lidhje me ngarkesën e ekzagjeruar të oficerëve të policisë (shih nën seksionin 4.1 Çështje të Përgjithshme/Cilësia e Punës), problemi që shtrohet këtu është ndikimi që ka kjo varësi e dyfishtë në ushtrimin eficient dhe të pavarur të funksioneve hetimore. Më shumë se një e treta e të gjithë prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore u përgjigjën në pyetësor se ligji nuk e parashikon qartë zinxhirin e komandës mes prokurorëve dhe oficerëve të policisë, të cilëve u besohet hetimi penal nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, mes oficerëve të policisë dhe eprorëve të tyre brendapërbrenda policisë. Prokuroria e Krimeve të Rënda doli me numrin më të lartë të përgjigjeve që zinxhiri i komandës nuk është i përcaktuar qartë.<sup>57</sup>

Prokurorët theksuan se si varësia funksionale e policisë gjyqësore prej tyre, siç parashikohet në kodin procedural, funksionon ndryshe në praktikë. Ky koncept përshkruhet më së miri me fjalët e të intervistuarve:

*"Marrëdhënia polici/prokurori është aktualisht një marrëdhënie mes prokurorisë si institucion dhe policisë si institucion. Megjithatë, kodi i procedurës ka tjetër gjë ndërmend, konkretisht kjo marrëdhënie është personale; është një marrëdhënie mes prokurorit dhe oficerit të policisë dhe jo institucionit të policisë."(prokuror)*

Ky kontekst ndikon tek hetimet dhe pengon rolin drejtues të prokurorisë. Disa raste ndërhyrjesh burokratike mund të shkaktojnë thjesht vonesa të panevojshme, p.sh. para se dosja e një çështjeje që përmban materiale kundër një autori të panjohur t'i dërgohet prokurorisë për hapjen e hetimit kërkohet firmosja e saj nga shefi i stacionit të policisë. Prokurorët janë të mendimit se kjo firmë është e panevojshme nga ana procedurale me dispozitat e reja të KPP-së.

54 Raporti Statistikor, Figura 251.

55 Raporti Statistikor, Figura 254.

56 Raporti Statistikor, Figura 255.

57 Raporti Statistikor, Figura 66.

Megjithatë, disa praktika të tjera ndikojnë ndjeshëm në sekretin e procedimeve për shkak të numrit të personave që vihen në dijeni për çështjet. U raportuan edhe disa raste kur çështje korrupsioni ishin diskutuar mes shefave të policisë para se çështja të dërgohej në prokurori dhe ishte diskutuar nëse duhet apo jo të bëhej referimi. Në çështjet shumë të njohura, prokurorët bëjnë përpjekje të veçanta për "të shmangur shefat", duke u mbështetur vetëm tek aftësitë dhe integriteti i oficerëve dhe duke qenë "veçanërisht të kujdesshëm që të mos ketë askush akses në informacion".

Nga intervistat duket se ndonjëherë ka shkëmbime email-esh mes oficerëve të ngarkuar me akte të caktuara hetimore dhe zinxhir të komandës së policisë për atë çka ka urdhëruar prokurori. Për më tepër, gjysma e policëve të shërbimit kanë deklaruar se kanë hasur personalisht situata ku në hetime çështjesh specifike, eprorë të tyre u kanë dhënë urdhra që binin ndesh me udhëzimet e prokurorëve.<sup>58</sup>

*"Kjo është ajo që ndodh, ne e delegojmë dosjen për veprime në polici. Që dosja të shkojë nga prokurori tek OPGJ-ja e shërbimit, ajo duhet të kalojë nëpër duart e shefave të policisë, të cilët bëjnë komente dhe urdhërojnë veprime që dalin mbi ato që urdhërojmë ne. Dhe OPGJ-ja nuk e di se çfarë të bëjë, sepse ata urdhrat i marrin nga prokurori, por paguhen nga shefat e tyre."(prokuror)*

Vlen të theksohet se si prokurorët, ashtu edhe policia gjyqësore e shërbimeve shprehen se në çështjet që kanë të bëjnë me hetimin e rasteve të deleguara nga prokurorët, policia e shërbimeve i bindet ndonjëherë urdhrave që vijnë nga administrata e policisë.<sup>59</sup> Kjo ndodh, për shembull, në rast vendimesh për arrestimin e të dyshuarve për vepra penale: pavarësisht mungesës së provave të mjaftueshme dhe/ose këshillimit të prokurorit për të mos proceduar me arrestim, arrestimi kryhet gjithsesi bazuar në urdhrin e dhënë nga zinxhiri i komandimit i policisë, duke mos qenë në gjendje që "të dalin kundër shefit" për shkak të respektimit të zinxhirit të komandës, nga frika e procedurës disiplinore<sup>60</sup> ose vlerësimit negativ të performancës.

Disa oficerë e vlerësojnë këtë gjendje të përshkruar si të pakënaqshme dhe pohojnë se në situata të ngjashme ata komunikojnë menjëherë me prokurorin dhe u thonë eprorëve të tyre në polici se urdhri i prokurorit është i ndryshëm, duke marrë kështu përsipër koston e qortimit nga shefat e policisë. Një sjellje e tillë bazohet në ndërgjegjësimin se, p.sh privimi i lirisë së një personi pa baza ligjore mund të sjellë përgjegjësi disiplinore dhe penale.

Prokurorët duket se marrin një qëndrim mjaft miqësor në situata kur urdhrat e tyre shkelen nga shefat e policisë dhe në shumicën e rasteve ua kufizojnë veprimet në kërkimin e shpjegimeve verbale nga oficerët përkatës të policisë.<sup>61</sup> Ky qëndrim pohon përsëri qasjen fataliste të prokurorëve që shprehet më së miri në këtë pohim:

*"Kemi 20 vjet që gënjehem se OPGJ-ja varet nga prokurori. Ata në fakt varen nga shefat e tyre. Ata nuk varen nga ne, vetëm në letra është kështu. Kështu që nëse u themi të bëjnë diçka, por eprorët e tyre u thonë të bëjnë diçka tjetër, ata do bëjnë atë tjetër." (prokuror)*

## 4.5 Strategjia e hetimit

Përgjigjet ndaj pyetësorëve tregojnë se teoria e hetimit zhvillohet në shumicën e çështjeve.<sup>62</sup> Duket se përdoret kryesisht për të identifikuar elementët e veprës penale që duhet provuar. Megjithatë, shumë të intervistuar shprehen se në këtë pikë, ata bëjnë një vlerësim nëse sjellja e raportuar ka elementët e një krimi, duke konfirmuar kështu vëzhgimin e pranisë së referimeve të shumta në prokurori, që nuk përbëjnë vepra penale.<sup>63</sup> Në kundërshtim me atë që nxjerrin pyetësorët, disa policë gjyqësorë komentojnë në intervista se prokurorët ndonjëherë nuk angazhohen efektivisht me oficerët përkatës në përpunimin e këtyre teorive hetimi:

58 Raporti Statistikor, Figura 68.

59 Raport Statistikor, Figura 69.

60 Raporti Statistikor, Figura 71.

61 Raporti Statistikor, Figura 70.

62 Raporti Statistikor, Figura 95

63 Raporti Statistikor, Figura 96

*"Ndryshimet më të fundit të KPP-së e kanë rritur vërtet ngarkesën e prokurorit. Ata shkojnë shpesh në gjykatë. Prandaj është e vështirë t'i takosh personalisht dhe të diskutosh mbi dosjen. Ata janë shumë të gatshëm të bashkëpunojnë me ne në çdo detaj, por tani është pak problem. Kështu që edhe çështjeve shumë të thjeshta nuk u kushtohet vëmendja e nevojshme. Por ky është realiteti. Pavarësisht faktit se për çështjet e rënda ne bëjmë çmos ... Megjithatë nuk mund ta diskutojmë në hollësi, personalisht, një çështje." (OPGJ seksione)*

Përveç kësaj, përfundimi i pyetësorëve tregon pasiguri të madhe midis të anketuarve për zhvillimin e kriterëve të përgjithshme për përcaktimin e prioriteteve në përzgjedhjen e çështjeve nga prokurorët<sup>64</sup>. Edhe brendapërbrenda grupit të të anketuarve që besojnë se të tilla kritere ekzistojnë, përveç kriterit të përgjithshëm të shkallës së çështjes, dalin përgjigje kontradiktore. Nga njëra anë, është perceptimi i orientuar drejt anës procedurale të prokurorëve, të cilët e vënë theksin tek mundësia ose probabiliteti i rezultateve të kënaqshme të hetimit, ndjekjes penale apo gjykimit; dhe nga ana tjetër – perceptimi i policisë gjyqësore, e cila thekson potencialin e një çështjeje për të gjeneruar ndikime të ardhshme për shkak të veçorive të saj sociale, politike apo juridike<sup>65</sup>. Ndonëse intervistat nuk lejuan marrjen e më shumë informacioneve rreth arsyeve për këtë pasiguri apo për ndikimin e saj në efektivitetin e prokurorëve në ushtrimin e funksioneve të tyre dhe në racionalizimin e përdorimit të burimeve, ato dhanë prapëseprapë informacione mbi përdorimin e prioriteteve si një mjet për menaxhimin e ngarkesës së punës.

Në fakt, intervistat me oficerët e seksioneve tregojnë se - në varësi të institucionit dhe burimeve njerëzore në dispozicion, secilit oficer i caktohen çështje nga disa prokurorë (deri në 8 çështje). Përveç situatave që kërkojnë përcaktim prioritësh *ex lege*, si p.sh. personat e arrestuar apo afatet që mund të skadojnë, apo çështjet e perceptuara si jo "aq të rrezikshme" sa të tjerat (p.sh. ndërtimet e paligjshme krahasuar me trafikimin e drogës), oficerët nuk duket se marrin ndonjë orientim për të vendosur prioritetet mes çështjeve as nga prokurorët as nga kryeprokurori dhe as nuk duket se ata vetë kërkojnë orientime të tilla. Në fakt, ndërkohë që çdo prokuror i sheh çështjet e veta si prioritet dhe kërkon që të trajtohen si të tilla, oficerët e policisë gjyqësore besojnë se u takon atyre ta shfrytëzojnë sa më mirë kohën dhe të garantojnë ecurinë e mirë të punës në rrethana të caktuara: "nuk kemi udhëzime të qarta se si të vendosim prioritetet, e bëjmë mbi bazën e përvojës".

Duket se më shumë gjasa të trajtohen si prioritet kanë hetimet e çështjeve të korrupsionit, ndonëse raporti statistikor tregon pasiguri të konsiderueshme mes të intervistuarve se kush i vendos prioritetet në zyrat e tyre (prokurori i ngarkuar me çështjen apo shefi i zyrës).<sup>66</sup>

Intervistat nuk krijuan mundësi për të mbledhur më shumë informacione të hollësishme për rrethana të veçanta që përcaktojnë zgjedhjen e përgatitjes së një plani të dedikuar hetimi apo një plani me përmbajtje specifike, përveç nocionit të prokurorëve se ky plan duhet të përshtatet me aftësitë dhe nivelin e njohurive të oficerëve të policisë gjyqësore:

*"... tani, kur bëj planin e hetimit, duhet të marr parasysh se cilit OPGJ do t'i shkojë dosja dhe, në varësi të aftësive të tyre, duhet të bëj një dosje edhe më të hollësishme, e madje edhe të hartoj pyetjet që duhet të bëjë OPGJ-ja" (prokurori)*

Pyetësorët dhe intervistat tregojnë qartë se në çështjet më komplekse, prokurorët shohin mundësinë e përdorimit të ekipeve shumë-disiplinore apo task-forcave.<sup>67</sup> Kjo metodë është veçanërisht e favorizuar në hetimet e çështjeve shumë të njohura, si p.sh. në veprat penale lidhur me korrupsionin.<sup>68</sup> Formacione të tilla të përbashkëta bëjnë të mundur hetim më të shpejtë, më të saktë dhe më të koordinuar<sup>69</sup>, por gjithashtu, siç u vu në dukje në intervista, mundësojnë edhe futjen e ekspertizave të posaçme, që vijnë, p.sh. nga policët gjyqësorë të tatimeve apo doganave. U përmendën kësh-tu disa përvoja pozitive me ekipet e përbashkët të prokurorëve, oficerëve të doganave, tatimeve, SHISH-it, ILDKPKI-së dhe Drejtorisë së Pastrimit të Parave që "vareshin direkt nga prokurori i çështjes dhe nuk u jepnin llogari mbikëqyrësve administrativë mbi atë që bënin."<sup>70</sup>

64 Raporti Statistikor, Figura 99.

65 Raporti Statistikor, Figura 100.

66 Raporti Statistikor, Figura 259. Ndonëse nuk e shprehën si arsye për dhënien prioritet të veprave penale të korrupsionit, shumica e të intervistuarve gjatë intervistave konstatuan se si afatet e hetimit, ashtu edhe parashkrimi për vepra të tilla janë tepër të ngjeshura, sidomos në çështjet shumë të njohura ose komplekse.

67 Raporti Statistikor, Figura 111-12.

68 Raporti Statistikor, Figura 269.

69 Raporti Statistikor, Figura 112.

70 Shih edhe nënseksionin 3.3 Ngritja e ekipeve të përbashkëta të përhershme dhe të përkohshme.



Duke pasur parasysh zhvillimet e fundit legjislativë, prokurorët janë të pasigurtë rreth mundësisë ligjore të krijimit të njësisë të përbashkëta në të njëjtin kuadër. Si zgjidhje, ata shohin mundësinë e delegimit të detyrave oficerëve të agjencive të ndryshme shtetërore, megjithatë kjo metodë nuk bën të mundur punën në grup dhe takimet e përbashkëta, si dhe nuk zgjidh problemet me zinxhirin e dyfishtë të komandës dhe shkeljet e mundshme të konfidencialitetit.

Përgjigjet ndaj pyetësorit nuk krijuan mundësi për deklarime përfundimtare nëse ekziston një sistem apo një sërë rregullash e procedurash për vlerësimin e efektivitetit të strategjive dhe praktikave të prokurorisë, duke përfshirë vendimmarrjen, si në Prokurorinë e Përgjithshme, ashtu edhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.<sup>71</sup> Intervistat treguan se disa oficerë policie konstatojnë se aktualisht një sistem i tillë nuk ekziston dhe se ata janë lënë pa mundësi ankimi ndaj vendimeve të prokurorit tek shefat e tyre, që ka qenë një opsion i mundshëm në të kaluarën për të mbikëqyrur dhe për të rishikuar veprimtarinë e prokurorit.

## 4.6 Ndjekja e hetimeve

Rezultatet e përgjithshme si nga sondazhi, ashtu edhe nga intervistat tregojnë se nuk ka qasje sistematike për dhënien e vlerësimeve apo komenteve për policinë gjyqësore lidhur me cilësinë e punës së tyre. Gjysma e oficerëve të shërbimeve nuk marrin kurrë informacione të tilla. Policët gjyqësorë të seksioneve marrin më shumë komente rreth padive dhe verdikteve të gjykatës<sup>72</sup>; e megjithatë kjo varet shumë nga faktorë si rëndësia e çështjes, iniciativa e tyre apo praktikata e çdo prokurori të veçantë apo asistenti administrativ.

*"Unë, për shembull, nuk e di se si mbyllet çështja në fund. Ndoshta as nuk më duhet ta di, po pse jo? Se ajo është edhe dosja ime..."*

*"...Prokuroria nuk e ka patjetër detyrim të na informojë mbi fatin e çështjes, por dosja është po aq e imja sa edhe e prokurorit. Kështu që edhe unë duhet ta di"*

*"Do të ndjeheshim të vlerësuar nëse do të kishim më shumë informacion dhe komente." (OPG seksione)*

Në këtë kontekst duhet theksuar se një shumicë e qartë mendon se krijimi i një sistemi për shkëmbimin e informacionit mbi paditë dhe vendimet do të rriste ndjenjën e të pasurit të qëllimeve të përbashkëta mes oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve.<sup>73</sup> Në intervista, disa prokurorë u shprehën gjithashtu se krijimi i një lidhjeje teknike midis Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve të Policisë së Shtetit, prokurorisë dhe gjykatave do të përmirësonte menaxhimin e çështjeve dhe do të harmonizonte mbledhjen e të dhënave.

Vështirësi teknologjike (p.sh me sistemin apo mospërputhje të tjera)<sup>74</sup> konsiderohen si arsye kryesore për problemet me shkëmbimin e informacionit midis prokurorëve dhe policisë gjyqësore. Përveç kësaj, pothuajse një në tre të intervistuar beson se arsyet lidhen më fushën, ndjeshmërinë e çështjeve dhe kufizimet ligjore lidhur me aksesin në informacione të caktuara.<sup>75</sup>

Pavarësisht opinionit të përgjithshëm të policisë gjyqësore se ata e konsiderojnë të rëndësishëm marrjen e vlerësimeve për punën e tyre, disa oficerë seksionesh shprehin shqetësim se kjo do të rriste në mënyrë të panevojshme ngarkesën e punës së tyre, pasi ata e kuptojnë marrjen e vlerësimeve vetëm në kuptimin e pjesëmarrjes personalisht në seancat gjyqësore.

71 Raporti Statistikor, Figura 114.

72 Raporti Statistikor, Figura 197.

73 Raporti Statistikor, Figura 198.

74 Raport Statistikor, Figura 200.

75 ibid

## 4.7 Hetimi dhe mbledhja e provave

*"Problemi më i madh procedural që kemi është se shumica e OPGJ-ve nuk kanë as kujdesin minimal në mbledhjen e provave në mënyrë që ato të pranohen. Provat mund të konsiderohen lehtësisht të papranueshme nga gjykata." (prokuror)*

Ky nënseksion mbështetet në gjetjet e nënseksionit 4.1. Çështje të përgjithshme/Cilësia e Punës, trajtimi i mungesës së aftësive dhe njohurive si një faktor pengues në procesin e mbledhjes së provave të pranueshme. Ai përqendrohet më tej në ndikimin që ka aksesin jokonsistent në bazat e të dhënave elektronike për mbledhjen e informacionit të nevojshëm si një faktor i rëndësishëm i jashtëm që pengon mbledhjen e provave. Vëmendje i kushtohet edhe përdorimit joproporcional të teknikave të posaçme të hetimit kundrejt metodave konvencionale për mbledhjen e provave, veçanërisht në kontekstin e hetimeve të veprave penale të lidhura me korrupsionin.

Procesi i mbledhjes së provave pengohet seriozisht nga mungesa e aksesit të përhershëm dhe të mjaftueshëm në bazat e të dhënave edhe pse policët gjyqësorë kanë nevojë për to në punën e tyre të përditshme.<sup>76</sup> Nevoja për të siguruar zbatimin e parimeve të mbrojtjes së të dhënave nuk diskutohet, megjithatë mbrojtja e të dhënave nuk duket të jetë shkak i kufizimeve që hasin prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në lidhje me aksesin në bazat e të dhënave elektronike, duke pasur parasysh faktin se të intervistuar të ndryshëm brenda të njëjtës kategori profesionale, p.sh. prokurorëve nga njësi të ndryshme territoriale, u janë dhënë nivele të ndryshme aksesit.<sup>77</sup> Mungesa e uniformitetit të aksesit, e pohuar edhe në intervista, çon në situatën paradoksale, ku persona që kanë të njëjtin funksion, nuk përfitojnë nga të njëjtat struktura në mënyrë standarde dhe të ngjashme.

Ajo çka është edhe më shumë shqetësuese është fakti që oficerët e policisë gjyqësore kanë më pak akses në disa baza të dhënash<sup>78</sup> (si p.sh. tek regjistrat e dënimeve penale apo në të dhënat financiare të kompanive) sesa prokurorët, që do të thotë se ata ose duhet të mbështeten tek prokurorët për kontrollin e thjeshta, gjë që rrit ngarkesën e punës së prokurorëve dhe ul efektivitetin e tyre, duke shkaktuar vonesa të panevojshme, ose të kërkojnë favore nga të tjerë që kanë akses, duke rrezikuar potencialisht integritetin e hetimit.

*"...ne nuk mund të marrim dot as edhe një certifikatë të thjeshtë vdekjeje, duhet të bëjmë një kërkesë zyrtare për ta marrë dhe të presim 2 javë derisa ta marrim... Kemi akses vetëm në TIMS dhe në shërbimet e gjendjes civile, por vetëm për certifikatat e lindjes, jo për certifikatat e vdekjes. As për sistemet bankare nuk mund t'i shohim gjërat online, as për kompanitë celulare."(OPGJ seksione)*

Megjithë mungesën e aksesit uniform në databazat elektronike, shumica dërrmuese i përdor ato deri në shkallën e lejuar në punën e tyre të përditshme.<sup>79</sup> E megjithatë, përveç kësaj, arsyet e tjera për përdorim të kufizuar të databazave gjenden në konstatimet se ato nuk janë të ndërlidhura dhe nuk përditësohen<sup>80</sup>.

Vlera e informacionit që përmbajnë databazat është mjaft e rëndësishme në kuadrin e hetimeve të veprave penale që lidhen me korrupsionin. Ky faktor radhites i dyti për nga rëndësia (pas disponueshmërisë së kuadrin të bashkëpunimit midis aktorëve të duhur) për suksesin e hetimit të çështjeve shumë të njohura.<sup>81</sup>

Sa i përket temës së metodave për mbledhjen e provave, një vëzhgim i veçantë u bë gjatë intervistave me prokurorët, d.m.th. fakti që policia gjyqësore e shërbimeve preferon të përdorë teknika speciale hetimi në rastet e korrupsionit dhe sidomos përgjime, duke nënvlerësuar përgjithësisht burime të tjera dhe duke mos shfrytëzuar plotësisht të gjitha mundësitë ekzistuese për mbledhje informacionesh dhe provash. Prokurorët e konsiderojnë këtë "problem mentaliteti" të oficerëve të policisë, të cilët duhet të shkojnë përtej rutinës së tyre të nisjes së një hetimi përmes përgjimeve dhe të fillojnë të përdorin burimeve të tjera informacioni:

*"Jo çdo gjë bëhet me përgjim. Policia nuk angazhohet tamam me njerëzit." (prokuror)*

<sup>76</sup> Raporti Statistikor, Figura 154.

<sup>77</sup> Raporti Statistikor, Figura 157.

<sup>78</sup> Raporti Statistikor, Figura 156.

<sup>79</sup> Raport Statistikor, Figura 158.

<sup>80</sup> Raporti Statistikor, Figura 159.

<sup>81</sup> Raporti Statistikor, Figura 236.

Policët, nga ana e tyre, mendojnë se nuk është çështje inercie, por mungesë bashkëpunimi nga qytetarët dhe institucionet, që i bën të përdorin teknikat e posaçme.

Rezultatet e pyetësorëve mund të çojnë edhe në shqetësime rreth përdorimit të tepruar të telekomunikacionit si mjete për mbledhjen e informacionit.<sup>82</sup> Ajo çka është edhe më e rëndësishme është që në disa raste prokurorët e gjejnë veten nën presion për të bërë një kërkesë në gjykatë për autorizimin e përgjimit, duke ditur se refuzimi nga gjykata mund të shkaktojë dyshime për korrupsion të vetë prokurorit.

Një çështje e rëndësishme e zbuluar gjatë analizimit të përfundimeve të pyetësorëve dhe intervistave duket se është vështirësia në marrjen e informacioneve për vepra penale që lidhen me korrupsionin. Ky duket se është një problem si për referimet që vijnë nga qytetarët, ashtu edhe nga institucionet e tjera. Një pikë e posaçme që ngrihet është se raportimi i korrupsionit ka më shumë gjasa të bëhet nga individët sesa institucionalisht:

*"Nga institucionet nuk kemi marrë asnjë informacion, vetëm nga njerëzit brenda këtyre institucioneve që mund të raportojnë në nivel personal, jo institucional."(prokurorët, OPGJ-të)*

Një arsye mund të jetë perceptimi i më shumë se gjysmës së të anketuarve se legjislacioni penal në fuqi nuk siguron mbrojtje efektive nga hakmarrjet apo frikësimet e mundshme të dëshmitarëve në procedimet penale, ku ata ofrojnë dëshmi për vepra penale që lidhen me korrupsionin<sup>83</sup>. Përveç kësaj, gjysma e të gjithë prokurorëve dhe OPGJ-ve të angazhuar në sondazh shprehen se nuk e kanë të lehtë të raportojnë për përfshirje të një OPGJ-je, prokurori apo gjyqtari në vepra penale të korrupsionit me sistemin aktual të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe sinjalizuesve<sup>84</sup>.

## 4.8 Raportimi

Si pyetësori, ashtu edhe intervistat tregojnë një problem të përgjithshëm në cilësinë e raporteve të policisë. Janë një numër shumë i vogël raportesh që vlerësohen si shkëlqyeshëm ose shumë mirë, vetëm një në tre përgjigje thotë se cilësia e raporteve është e mirë dhe më shumë se gjysma që shprehen se cilësia e raporteve është ose mesatare ose jo e mirë.<sup>85</sup> Mangësitë kryesore të raporteve të policisë duket të jenë mospërshkrimi sa duhet i fakteve dhe rrethanave të veprave të dyshuara<sup>86</sup>. Prokurorët konstatojnë se shpesh raportet thjesht përmbajnë informacion se ka ndodhur një ngjarje, pa dhënë një analizë nëse përbën vepër penale apo jo, kush janë personat e përfshirë dhe cilat janë rrethanat e ngjarjes:

*"...oficerët nuk e dinë së çfarë referojnë. Nuk e kuptojnë. [Ne] duhet t'i lexojmë aktet një për një për të kuptuar se çfarë fakti kriminal ka, sepse oficerët ndonjëherë edhe datat i vënë gabim... nuk bëjnë një analizë se cila është vepra penale që ka ndodhur. Pjesa tjetër është vetëm përshkrim i veprimeve të OPGJ-së pa asnjë lloj logjike apo ndonjë shpjegim se pse e kanë nisur hetimin."(prokuror)*

Më pak shqetësuese, por të perceptuara me po aq mangësi janë raportet me gjuhë të varfër dhe ato që përgatiten duke kopjuar shabllon informacione nga raporte mbi ngjarje të ngjashme.

Mangësitë e përshkruara më sipër janë gjetur edhe në rastet e dyshimeve për korrupsion. Këtu, cilësia e pakënaqshme e raporteve lidhet me hezitimin e policëve për të raportuar raste që përfshijnë zyrtarë të lartë. Ndryshe nga kjo dhe sa i përket shumicës dërrmuese të rasteve që përfshijnë zyrtarë të ulët, prokurorët e vlerësojnë gatishmërinë e policisë për të raportuar, por vënë në pikëpyetje motivet e vërteta të raportimeve. Sipas tyre, në shumicën e rasteve raportimi bëhet vetëm për të justifikuar çdo masë shkarkimi të marrë ndërkohë kundër zyrtarëve në fjalë. Për më tepër, prokurorët ankohen se në raste ekstreme, gjeneralitetet e personave të dyshuar për praktika të dyshuara korruptive as nuk raportohen fare.

82 Raporti Statistikor, Figura 267.

83 Raporti Statistikor, Figura 248.

84 Raporti Statistikor, Figura 250.

85 Raporti Statistikor, Figura 168.

86 Raporti Statistikor, Figura 169.

Në përgjithësi, prokurorët konstatojnë se raportet për veprat penale të korrupsionit të përgatitura nga policia gjyqësore e doganave dhe ndonjëherë - ajo tatimore, janë të një cilësie më të mirë, ndoshta për shkak të nivelit më të lartë të specializimit, njohjes së legjislacionit dhe formimit të duhur arsimor të oficerëve përkatës të policisë gjyqësore në këto agjenci shtetërore.

Në shumë raste, prokurorët marrin raporte nga policia edhe pse është e qartë se ato nuk përmbajnë asnjë tregues se ka ndodhur një vepër penale - p.sh. raporte për shkatërrimet e pronave për shkak të tërmeteve. Oficerët e shërbimeve shprehen se vetëm prokurorët që "*kanë autoritetin për përgjegjësinë për të marrë vendime*" mund të vlerësojnë ligjërisht nëse një ngjarje e caktuar i ka veçoritë e një veprë penale. Megjithatë, prokurorët konsiderojnë si arsye të mundshme për këtë praktikë edhe mungesën e njohjes së elementeve të veprave penale, si dhe tendencën për ta bërë këtë me qëllim rritjen e statistikave për ngarkesën e punës së policisë.

Oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve mundën të japin edhe një tjetër arsye për referimin e raporteve që nuk përmbajnë informacione për vepra penale:

*"Dikush që humbet telefonin ankohet tek Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Policisë, sepse i themi se kjo nuk përbën vepër penale, por ai nuk na beson. Kështu që, ne duhet ta raportojmë edhe pse nuk është vepër penale dhe pastaj t'ia dërgojmë prokurorit." (OPGj shërbime)*

Ndryshe nga kjo, prokurorët duken se kanë një qasje "fataliste/formaliste", kur vjen fjala tek hapat për zgjidhje. Në fakt, kthimi i raportit sërish te policia për përmirësimin e cilësisë apo për plotësime konsiderohet si "proceduralisht e pamundur" nga të intervistuarit. Ndonëse ky opsion u raportua se ekzistonte me kodin e vjetër, prokurorët besojnë se tani ata mundet që ose ta regjistrojnë raportin ose ta pushojnë atë brenda 15 ditësh nga marrja e tij. Vetëm për ato "procès-verbaux" që janë me jashtëzakonisht mangësi dhe që nuk mund të konsiderohen si raporte veprash penale për t'u proceduar, prokurorët besojnë se mund t'ia kthejnë policisë nga "pikëpamja administrative". E megjithatë, ky opsion administrativ mendohet se ndodh rrallë dhe nuk shihet si me ndonjë vlerë të madhe, pasi policia nuk do të angazhohej sërish për të gjetur informacione për të pasuruar dosjen.

Ndonëse pranohet se kjo zgjidhje nuk aplikohet aktualisht, disa prokurorë mendojnë se përcaktimi i një procedure, përmes së cilës raportet të vlerësohen nga prokurorët para se të regjistrohen - mundësisht nga prokurori në shërbim, mundet që raportet jo cilësore t'i kthehen policisë para se ato të regjistrohen.

Gjatë intervistave nuk u arrit të merrej asnjë informacion për mënyrën se si e shohin prokurorët zgjidhjen e mundshme për detyrimin që kanë për të regjistruar veprat penale të pretenduara dhe për të udhëzuar sipas rastit policinë gjyqësore.

Në këtë kontekst, duhet shtuar se në disa raste, hezitimi i prokurorëve për të ndërmarrë hapa zgjidhjeje ndaj raporteve jo cilësore - qoftë duke ia kthyer ata policisë apo duke mos i pranuar bashkë me çështjen - shpjegohen me mungesën e perceptuar të besimit (të publikut ose zyrtarëve publikë) tek gjykimi i prokurorit për të mos e nisur një hetim për shkak të problemeve të materialit të siguruar nga policia dhe frikës që vjen si pasojë nga presionet dhe/ose ekspozimi ndaj akuzave për mbështetjen e kriminalitetit përmes vendimeve të pushimit.

Në raste si ata që përmenden më sipër, raportet jo të kënaqshme në shumë raste mund të mos përfshihen në dosjen e çështjes dhe çështja t'i dërgohet gjyqtarit, pavarësisht se çfarë mundësisht ka për sukses të procedimit.

Në raste të tjera, mbetet në dorë të prokurorëve të identifikojnë faktet relevante dhe ta kthejnë raportin fillestar në një dosje të saktë të çështjes; dhe ata besojnë se fajin për mosgjetjen e informacioneve të nevojshme që mungojnë do t'ua hedhin po atyre.

Ndonëse që të gjithë të intervistuarit bien dakord se duhet të gjendet një mekanizëm për zgjidhjen e këtij problemi, policia thekson nevojën për të pasur procedura standarde për këtë çështje për të mbrojtur më mirë oficerët nga pretendimet e mundshme për mosveprim.

## 4.9 Përkatësia gjinore

Sondazhi dhe intervistat nuk shfaqin ndonjë problem me përkatësinë gjinore. Prokurorët dhe OPGj-të në përgjithësi mendojnë se gjinia e kolegëve të tyre nuk ka rëndësi për ta dhe se ajo nuk ndikon në

preferencat e tyre se me kë dëshirojnë të punojnë. Po ashtu, në analizimin e këndvështrimit gjinor në kontekstin e rolit drejtues të prokurorëve<sup>87</sup>, përgjigjet tregojnë se nuk ekziston ndonjë preferencë për të zbatuar urdhrat apo udhëzimet që vijnë nga prokurorët meshkuj apo ndonjë rezistencë nga oficerët e policisë ndaj ndikimit dhe rolit drejtues të femrave.

Megjithatë, vlen të theksohet se disa prej përgjigjeve në intervista tregonin për një lloj vetëdijeje se oficeret femra merrin më mirë me raste specifike, si p.sh. me rastet e trafikimit të qenieve njerëzore për shfrytëzim seksual dhe rastet e dhunës seksuale.

Në disa intervista, prokurorët femra theksuan se ato tentojnë ta vendosin autoritetin duke qenë "më të ashpra" ose duke qenë të detyruara "të bërtasin gjatë të gjithë kohës", por këto konstatime nuk mjaftojnë për të thënë se ekziston një tendencë e tillë e veçantë.

## 4.10 Trajnimi dhe udhëzimet

Disa prej faktorëve që ndikojnë në efikasitetin dhe efikasitetin e policisë gjyqësore janë mundësitë e pamjaftueshme për trajnim dhe sistemet e papërshtatshme të trajnimit.<sup>88</sup>

Përgjigjet e pyetësorit tregojnë se të paktë janë oficerët e seksioneve që kanë marrë trajnime fill-estare.<sup>89</sup> Më tej, intervistat tregojnë se trajnimet fillestare kanë qenë kryesisht teorike dhe se kishin të bënin më shumë me legjislacionin se sa me fokusimin në kryerjen e hetimeve. Oficerët e seksioneve duket se e marrin përvojën me hetimin përmes punës me hetime konkrete dhe - edhe nëse kanë vite pune - ata besojnë se kanë nevojë për trajnime për metoda hetimi për vepra penale që kërkojnë aftësi të specializuara (p.sh. për krime ekonomike, krimet kundër të miturve, dhuna në familje, etj.), si dhe për asistencë ligjore ndërkombëtare dhe për risitë legjislative.

Kur vjen fjala tek aspektet organizative, oficerët e seksioneve besojnë se u duhen dhënë mundësi të barabarta për të aplikuar trajnime, si dhe për t'u përfshirë në kalendarin e trajnimeve të përgatitur nga Shkolla e Magjistraturës për gjyqtarët dhe prokurorët dhe se sistemi aktual nuk është transparent dhe favorizon qartësisht trajnimin e prokurorëve. Për më tepër, atyre u duhen dhënë mundësi trajnimi në fusha jashtë specializimit të tyre aktual.

Rezultatet e pyetësorit dhe të intervistave tregojnë se ndryshe nga policia gjyqësore e seksioneve, oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve trajnohen më shpesh - si nga Akademia e Sigurisë, ashtu edhe përmes trajnimeve të organizuara nga organizatat ndërkombëtare. Megjithatë, ajo çka duket se paraqet problem është organizimi i trajnimeve: mundësitë aktuale për trajnim të vazhdueshëm ekzistojnë kryesisht në nivel drejtorie të përgjithshme dhe shumë shpesh të njëjtët oficerët dërgohen për të marrë pjesë në të njëjtin trajnim disa herë, duke privuar kështu kolegët e tyre nga mundësitë për të përfituar eksperiencë.

Një pjesë e mirë e trajnimeve të përbashkëta të specializuara - p.sh. për inteligjencën financiare, mbledhjen e provave, gjurmimin dhe ngrirjen e asetëve ose për të drejtat e njeriut janë dhënë nga agjencitë ndërkombëtare. Sa u përket agjencive vendase, është vetëm Shkolla e Magjistraturës që u përmend në përgjigjet e pyetësorit<sup>90</sup>. Kur vjen fjala tek vlerësimi i kapacitetit të institucioneve vendase për të ofruar trajnime të specializuara pa mbështetjen e organizatave ose programeve ndërkombëtare, opinionet janë të ndryshme. Del gjithashtu se opinioni vetëm i prokurorisë së specializuar - Prokuroria e Krimeve të Rënda, është fuqimisht pro ruajtjes së nivelit të mbështetjes së aktorëve ndërkombëtarë.

Prokurorët bien dakord për nevojën e ofrimit të trajnimeve të specializuara për policinë gjyqësore - p.sh. për çështjen e ligjshmërisë procedurale dhe vlefshmërisë së provave - pasi puna e përditshme dhe shkëmbimet mes tyre nuk duket se kanë pasur ndikim efikas në cilësinë e hetimeve. Disa sugjerojnë që të organizohen aktivitete "brenda institucioneve", konkretisht seanca trajnimi për çështje procedurale të ofruara nga prokurorët që punojnë në territorin e drejtorive përkatëse të policisë.

Oficerët e seksioneve duken më pak të prirur për të kontribuar në trajnime për t'u dhënë kolegëve

87 Raporti Statistikor, Figura 65.

88 Raporti Statistikor, Figura 4.

89 Raporti Statistikor, Figura 211.

90 Raporti Statistikor, Figura 229.

të shërbimeve njohuri rreth aspekteve ligjore të hetimit. Arsyet për këtë, të cilat variojnë që nga mungesa e kohës e deri tek perceptimi se pjesëmarrja në këto trajnime nuk do të ishte përfituese apo se këto nisma të seksioneve nuk do të mirëpriteshin nga kolegët e shërbimeve.

Trajnimet e përbashkëta përbëjnë një instrument të dobishëm për përmirësimin e bashkëpunimit dhe komunikimit mes përfaqësuesve të agjencive të ndryshme. Duket se trajnimet e përbashkëta për tema thelbësore (p.sh. inteligjenca financiare, mbledhja e provave, rikuperimi i aseteve, të drejtat e njeriut) janë të zakonshme.<sup>91</sup> Por, për të plotësuar nevojat e mjediseve komplekse ku funksionojnë dhe, veçanërisht për të përmirësuar kapacitetin për bashkëpunim dhe koordinim, prokurorët mendojnë se trajnimet e përbashkëta të specializuara që do të përfshinin ata dhe oficerët e shërbimeve dhe të seksioneve do të ishin shumë të dobishme:

*"Për shkak se puna në grup në hetimin e krimeve të caktuara është shumë e dobët, unë kam caktuar një OPGj për çdo seksion dhe ata nuk koordinohen dot, po nuk i thirra dhe nuk i koordinova unë. Përveç kësaj, përpiqen t'ia kalojnë punën njëri-tjetrit. Ata ankohen se nuk e bëjnë dot punën, por kur angazhohesh për të përfshirë më shumë se një oficer, përfundon që asnjëri prej tyre nuk punon. Besoj se kanë nevojë për trajnim për të punuar në ekip." (prokuror)*

Një shqetësim i zakonshëm është mungesa e mjeteve, si manualeve, procedurave standarde të operimit, listave të kontrollit, udhëzuesve në ndihmë të prokurorëve dhe OPGj-ve në punën e tyre të përditshme. Prokurorët mendojnë se do të ishte e dobishme të përgatiteshin udhëzues me modele dokumentesh të ndryshme procedurale ose Manuale për metodat hetimore të veprave penale specifike, të cilat do të lehtësonin nga njëra anë punën e policisë gjyqësore dhe do të unifikonin praktikën nga tjetra.

<sup>91</sup> Raporti Statistikor, Figura 226.

## 5. Përmbledhje e gjetjeve kryesore

Reforma në drejtësi e kohëve të fundit në Shqipëri arriti të krijojë një qeverisje të pavarur në gjyqësor, por a ndikoi ajo në dinamikat e bashkëpunimit mes prokurorëve dhe policisë gjyqësore? Pavarësia e prokurorëve është përforcuar; struktura hierarkike e prokurorisë nuk ndikon më në kompetencat vendimmarrëse të prokurorëve dhe roli i krerëve të prokurorisë, duke përfshirë edhe Prokurorin e Përgjithshëm, kufizohet në garantimin e mbështetjes organizative dhe në ofrimin e orientimeve metodologjike, por nuk mundësojnë më ndërhyrjet në hetime konkrete.

Pavarësia është e ndërlidhur me fuqizimin e rolit të prokurorit si drejtues dhe 'kryesues' i hetimeve paraprake. Prokurorët dhe policia gjyqësore e pranojnë këtë rol, i cili është i padiskutueshëm. E megjithatë, nuk është ende e qartë se sa të përgatitur janë prokurorët për këtë. Prokurorët duken disi pasivë në punën e tyre: janë të pakta çështjet e hapura me nismën e vetë prokurorëve dhe përfshirja e tyre në hetimet paraprake kufizohet ndonjëherë me mbikëqyrjen e punës së policisë gjyqësore. Ndryshimet e fundit në KPP, të cilat kërkojnë kontroll gjyqësor ndaj masave të caktuara procedurale dhe hetimore çuan në një angazhim më të madh të prokurorëve në gjykata dhe ndikuan në disponueshmërinë e tyre për të drejtuar dhe orientuar oficerët e policisë gjyqësore, përveçse në çështje shumë komplekse dhe të vështira.

Në këtë kuadër, policia gjyqësore e shërbimeve dhe e seksioneve përballet me sfida të shumta, të cilat prekin negativisht cilësinë e punës së tyre dhe si rrjedhojë, bashkëpunimin me prokurorët.

Ajo çka duket se perceptohet si problem madhor është lëvizja e shpeshtë e oficerëve të policisë së shërbimeve në Policinë e Shtetit. Procedura e re, e futur me Ligjin e miratuar së fundmi për Policinë Gjyqësore, do të duhet të sfidojë mentalitetin e konsoliduar sa u përket procedurave ekzistuese të transferimeve deri tani, të cilat ofronin garanci të pamjaftueshme ndaj veprimeve arbitrare të shefave të policisë dhe lejonin në këtë mënyrë përdorimin e tyre si masë për vendosje sanksionesh ose për të ushtruar presione - të drejtpërdrejta apo të tërthorta - ndaj oficerëve individualë. Ndonjëherë, transferimet justifikohen me interesin e organizatës apo edhe kamufllohen si ngritje në detyrë, por në fund shkaktojnë mungesë stabiliteti, humbje motivimi dhe pamundësi për të përfutur ekspertizën e mjaftueshme nga ana e oficerëve të policisë së shërbimeve. Përfundimisht, lëvizjet e shpeshta të oficerëve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit pengojnë hetimet dhe ndikojnë kështu negativisht në besimin mes prokurorëve dhe policisë gjyqësore.

Shkeljet e konfidencialitetit nuk janë të pazakonta - ndonjëherë të shkaktuara nga tentativat për promovimin e punës së policisë përmes medias para se çështjet t'i raportohen prokurorit. Në raste të tjera, zinxhiri i gjatë dhe i paqartë i personave të përfshirë në administrimin e dosjeve të çështjes mes prokurorëve dhe drejtorëve të policisë krijon një mjedis të favorshëm për 'rrjedhjen' e informacioneve delikate, pasi është e pamundur të zbulohet se si ka ndodhur shkelja e sekretit hetimor dhe se kush është përgjegjës për të.

Hapat korrigjues të ndërmarrë nga disa prokurorë, d.m.th. mbajtja e dosjeve të çështjeve në zyrat e tyre dhe thjesht delegimi i disa veprimeve specifike mundet që vërtet ta mbrojë konfidencialitetin e hetimit, por kjo i privon oficerët e policisë gjyqësore nga mundësia për të pasur një tablo të plotë të çështjes dhe për të planifikuar dhe zhvilluar më mirë strategjinë e hetimit.

Pozicioni specifik i oficerëve të policisë së shërbimit në policinë e Shtetit - nga ana funksionale të varur nga prokurorët dhe nga ana administrative nga shefat e policisë, i bën ata të cenueshëm kur vjen fjala tek nxjerrja e aspekteve të caktuara të hetimit. Duket se materialet e përgatitura nga oficerët për t'u dorëzuar në prokurori kërkojnë firmën e shefit; edhe dokumentet konfidenciale, si kërkesat për teknika të posaçme hetimi duhet të raportohen në hierarkinë e policisë me arsyetimin se informacioni që ato përbajnë duhet për të vlerësuar ngarkesën e oficerëve.

Varësia e dyfishtë e oficerëve të policisë gjyqësore në policinë e Shtetit ndikon në disponueshmërinë e tyre dhe përcakton fokusin e punës së tyre sipas prioriteteve të policisë. Dinamikat e drejtorëve të policive kërkojnë shpesh që oficerët të merren para së gjithash me "fushatat e fokusit" ose të raportojnë në kurriz të detyrave hetimore.

Ndonëse pozicioni sistematik i policisë së shërbimeve duket se është një faktor që çon në këtë rezultat, harmonizimi në të ardhmen mes ligjit për policinë gjyqësore dhe ligjit për policinë e shtetit mund

të krijojë mundësi për një zgjidhje efikase, përmes ngritjes së një strukture më vete hetimore pranë policisë së shtetit, e cila do të varej direkt nga prokuroria dhe do të merrej me detyra hetimore dhe jo detyra policore parandaluese.

Përgjithësisht ngarkesa e ekzagjeruar e oficerëve të policisë së shërbimeve shihet si pasojë e mungesës së numrit të mjaftueshëm të personelit të kualifikuar në policinë e Shtetit dhe në agjenci të tjera qeveritare që merren me hetime. Megjithatë, ajo çka prek veçanërisht punën e shërbimeve të policisë së Shtetit është disproporcioni mes oficerëve me përvojë dhe oficerëve të rinj. Ligji për Policinë Gjyqësore e heq kërkesën për përvojë minimale dhe trajnim fillestar sa i përket rekrutimit të oficerëve gjyqësorë në policinë e Shtetit për të mundësuar plotësimin e shpejtë të vendeve, por derisa këta oficerë të sapo emëruar të fitojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme duhet kohë dhe përpjekje të dedikuara.

Përveç të gjithë elementëve të përmendur më sipër, sistemi i ri i ngritjes në detyrë të oficerëve të policisë gjyqësore duket i paqartë dhe ngre disa pyetje rreth zbatimit të tij në praktikë. Ndonëse këto mund të adresohen me efikasitet nga KPGJ-ja në të ardhmen, për momentin ngrihen shqetësime që mund të ndikojnë në motivimin e policisë gjyqësore.

Bashkëpunimi dhe bashkërendimi mes prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve bazohet në parakushte të ndryshme nga ato të ndërveprimit me policinë e shërbimeve. Oficerët e seksioneve janë përgjithësisht të trajnuar mirë dhe kanë përvojë të mjaftueshme për kryerjen e hetimeve. Për shkak se gjenden fizikisht në zyrat e prokurorive dhe duke qenë se qarkullimi i stafit të seksioneve nuk paraqet ndonjë problem, ata janë në gjendje të krijojnë marrëdhënie pune të afërta dhe afatgjata me prokurorët. Kjo afërsi - po aq sa shihet si avantazh kur vjen fjala tek ndërveprimi, shihet edhe si pengesë, pasi krijon largësi nga terreni. Përveç kësaj, oficerëve të seksioneve u mungon infrastruktura e nevojshme për t'u marrë me punë operationale, p.sh. automjete, korrierë, akses në baza të dhënash, që ndikojnë në kapacitetin e tyre për të ofruar një 'shërbim' të plotë për prokurorët në disa hetime.

Mund të mendohet se këto dy struktura - shërbimet dhe seksionet, mund të përfitonin reciprokisht nëse do të punonin në bashkëpunim dhe partneritet të ngushtë. Në fakt, duket se i vetmi emërues i përbashkët për ato të dyja në hetime të caktuara është prokurori, por nuk është se bëhen përpjekje të mëdha në ekip, qoftë nga njëra apo tjetra strukturë. E megjithatë - dhe në këtë kontekst specifik, është roli i prokurorit si drejtues i hetimit që të zbatojë dhe të mundësojë një ndërveprim dhe komunikim efikas mes anëtarëve të ndryshëm të ekipeve hetimore.

Përveç zgjidhjes afatgjatë, e cila do të kërkonte ndryshime në perceptimin si të prokurorëve, ashtu edhe të oficerëve të policisë gjyqësore për rolet e tyre në hetime konkrete dhe për natyrën e bashkëpunimit të tyre, një zgjidhje e shpejtë mund të gjendet duke rigjallëruar praktikën e kohëve të fundit të njësive të përbashkëta hetimore. Me ngritjen e strukturave të përhershme që përfshijnë prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore nga seksione dhe shërbime të ndryshme, hetimet do të përfitonin nga ekspertiza e grumbulluar e profesionistëve të ndryshëm dhe nga një komunikim më i mirë mes anëtarëve të ekipit.

Më tej duhet të shihet edhe ideja e modifikimit të funksioneve të policisë gjyqësore të seksioneve. Duke u mbështetur në pikat e tyre më të forta - njohurinë materiale dhe procedurale dhe përvojën e tyre, ata mund të ofrojnë ndihmë të çmuar për prokurorët në aspekte të caktuara administrative të punës. Kjo figurë njihet mirë në shumë sisteme prokurorie në Evropë, p.sh. në Holandë, ku "asistenti prokuror", zakonisht një oficer i lartë policie, autorizohet për të shtyrë afatin e paraburgimit, duke i çliruar kështu prokurorët nga detyrat përsëritëse dhe më pak komplekse.

Sfidat e shumfishta të oficerëve të policisë së shërbimeve që ndikojnë negativisht në performancën e tyre i motivojnë ndonjëherë prokurorët që t'u delegojnë hetimet komplekse dhe të vështira oficerëve të seksioneve. Kjo, nga ana e vetë, rrit ngarkesën e këtyre të fundit dhe çon në nevojën për menaxhimin me urgjencë të detyrave të shumta dhe të ndryshme hetimore. Në këtë situatë, përcaktimi i prioritetëve lihet në dorë të çdo oficeri, i cili e bën këtë thjesht me logjikë, por shpesh vendos në bazë të shkaillës së presionit të ushtruar nga prokurorë të veçantë. Rregullat për përcaktimin e prioritetëve mes çështjeve do ta zgjidhnin këtë çështje dhe do të ofronin një terren të qartë ku prokurorët mund të mbështesin pritshmëritë e tyre.

Një nga karakteristikat e rolit drejtues të prokurorëve që përbën një dallim të ndjeshëm mes statusit aktual dhe atij të dëshiruarit është ajo e "përgjegjësisë së përbashkët për sukseset dhe dështimet e hetimit". Siç përcaktohet në këtë Raport, nuk ka mekanizma efikasë - formal apo informal, që t'u japin mundësi oficerëve të policisë gjyqësore të marrin komente vlerësuese për performancën e



tyre në mënyrë sistematike dhe konsistente, sidomos kur bëhet fjalë për rezultatet e hetimit në gjykatë. Një mekanizëm i tillë do të lehtësonte ndërveprimin dhe do të sillte si përfitim ndjesinë e të pasurit të qëllimeve të përbashkëta.

Kjo mund të arrihet me përdorimin e sistemeve përkatëse të menaxhimit të çështjeve në polici, prokurori dhe gjykatë, në momentin që këto sisteme ndërliken me njëri-tjetrin. Një tjetër përfitim i mundshëm i zbatimit të kësaj zgjidhjeje teknike do të ishte menaxhimi më i mirë i fluksit të punës dhe raportimi dhe rezultatet statistikore më të mira.

Në përgjithësi, cilësia e raporteve të policisë duket e pakënaqshme. Përveç të gjithë faktorëve të sipërpërmendur që ndikojnë negativisht në punën e oficerëve të policisë së shërbimeve, mungesa e një sistemi vlerësimi apo mekanizmi para regjistrimit apo dorëzimit të tyre në prokurori kontribuon edhe më shumë në këtë rezultat të pakënaqshëm.

Për më tepër, shumë prej mangësive në performancën e policisë gjyqësore nuk adresohen si duhet përmes trajnimeve të përshtatshme. Mungesa e trajnimit fillestar nga njëra anë dhe trajnimet e pamjaftueshme në vazhdim si për oficerët e policisë së shërbimeve, ashtu edhe për ata të seksioneve, ndikojnë ndjeshëm në performancën e tyre dhe rrjedhimisht edhe në marrëdhënien e bashkëpunimit me prokurorët. Fushat që kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme janë raportimi mbi hetimet dhe metodat e mbledhjes së provave. Ndryshimet në metodat e trajnimit, p.sh. trajnime të përbashkëta për prokurorët dhe policinë gjyqësore janë po aq të nevojshme, si dhe një sistem i drejtë dhe transparent për aplikime për trajnime që do të ofronte akses të barabartë për të gjithë profesionistët e interesuar, pavarësisht nga preferencat e shefave apo eprorëve të tyre.

Përkatësia gjinore nuk duket se luan rol në marrëdhëniet mes prokurorëve dhe policisë gjyqësore. Ndonëse, përgjithësisht kjo nuk duket se përbën ndonjë faktor në bashkëpunimin mes profesionistëve të ndryshëm, i kushtohet rëndësi përfitimëve të përfshirjes së OPGj-ve femra në veprime të caktuara hetimore.

## 6. Rekomandime

Për të trajtuar mangësitë në bashkëpunimin dhe koordinimin efektiv ndërmjet prokurorëve dhe policisë gjyqësore, rekomandohet që përfituesit e projektit të marrin masa të mëtejshme në këto tri fusha kryesore:

### 6.1 Masat në nivel legjislativ dhe rregullator

- Të ndryshohet Ligji për Policinë e Shtetit për të garantuar përputhshmërinë me Ligjin për Policinë Gjyqësore lidhur me ngritjen e një strukture hetimore nën varësinë formale dhe substanciale-funksionale të prokurorëve, si dhe ndërkohë:
- Të zbatohet ndarja rregullatore ndërmjet detyrave hetimore dhe detyrave policore të zbatimit për OPGj-të e Shërbimit, me qëllim që të garantohet cilësia, efektiviteti, afatet kohore dhe pavarësia e hetimeve të udhëhequra prej prokurorëve.
- Të rishihet roli i oficerëve të policisë gjyqësore në seksione dhe të shikohet mundësia e futjes së sistemit me ndihmës-prokurorë/këshilltarë për të shfrytëzuar më mirë aftësitë e tyre juridike dhe profesionale.
- Të rritet transparenca në procesin e transferimeve të oficerëve të policisë gjyqësore në shërbime si edhe të ngrihet një mekanizëm efektiv kontrolli që ushtrohet nga Komisioni i Policisë Gjyqësore.
- Të kufizohet transferimi i OPGj-ve të Shërbimit në rastet e nevojave operacionale serioze dhe të dokumentuara, me qëllim që të garantohet vazhdimësia e veprimeve hetimore si dhe përfitimi dhe ruajtja e aftësive profesionale dhe hetimore.
- Të miratohen rregullore dhe udhëzime të brendshme që përforcojnë bashkëpunimin ndërmjet OPGj-ve të Shërbimit dhe OPGj-ve të Shërbimit dhe kur është e nevojshme të miratohen procedura efektive për këtë bashkëpunim, përfshirë ngritjen e një sistemi të qartë për shpërndarjen e çështjeve dhe detyrave, me qëllim që të garantohet përdorim strategjik, racional dhe efikas i burimeve njerëzore hetimore në dispozicion të prokurorëve.
- Të hartohen rregulla standarde për prioritizimin e çështjeve si edhe udhëzimeve ndërinstitucionale prioritizimi për OPGj-të që merren me disa çështje që caktohen nga prokurorë të njëjtë apo të ndryshëm.
- Të rishikohen rregullat ose nëse është e nevojshme të hartohen rregulla të reja për shkëmbimin e dosjeve gjyqësore dhe informacionit ndërmjet prokurorisë dhe policisë për të shmangur: 1) rreziqet e shkeljes së sekretit hetimor para dhe pas regjistrimit të çështjes në prokurori, si dhe 2) paragjykimet për kryerjen e hetimeve aktuale apo të ardhshme nga ana e prokurorëve.
- Të hartohen rregulla për komunikimin me median për problematika që lidhen me hetimet penale dhe natyrën konfidenciale të tyre.
- Të miratohen dhe të zbatohen masa dhe procese efektive për hetimin e rasteve të shkeljes së sekretit hetimor si edhe të ashpërsohen sanksionet disiplinore apo penale ndaj këtyre shkelësve.
- Të miratohen masa në nivel kombëtar që garantojnë se pretendimet legjitime për punë të dobët të prokurorëve të mos shndërrohen në mjete abuzive dhe jolegjitime presioni ndaj prokurorëve që të kryejnë apo të mos kryejnë veprime legjitime hetimore apo ndjekjeje penale.

- Të miratohen mekanizma dhe procedura për policinë gjyqësore dhe prokurorët që të vlerësojnë cilësinë e kallëzimeve para regjistrimit në prokurori dhe, nëse është e nevojshme – për prokurorët që të japin orientime për masa/përmirësime të mëtejshme.
- Të vendoset detyrimi që policia gjyqësore të raportojë dhe detyrimi që prokurorët të shqyrtojnë materialet e hetimit para finalizimit dhe para dorëzimit të dosjes gjyqësore me relacionin përfundimtar në prokurori.
- Të miratohen procedura të koordinuara, efektive, me afate dhe më të strukturuar për konsultimin e OPGj-ve me prokurorët lidhur me zbatimin e legjislacionit të ri apo ndryshimeve të legjislacionit ekzistues për me funksionet apo statusin e tyre.
- Të përforcohet dhe të bëhet efektiv sistemi i mbrojtjes së dëshmitarëve dhe sinjalizuesve në çështjet e korrupsionit dhe në çështjet kundër zyrtarëve të lartë shtetërorë.

## 6.2 Masat në nivel organizativ

---

- Të hartohen dhe të zbatohen zgjidhje teknike efektive që mundësojnë ndërlidhjen e sistemeve të menaxhimit të çështjeve të Policisë së Shtetit, prokurorisë dhe gjykatave.
- Të garantohej përdorim më i gjerë i ekipeve të përbashkëta hetimore që kanë në përbërje OPGj me ekspertizë të ndryshme në hetimin e çështjeve të ndërlikuara dhe veçanërisht në veprat penale të korrupsionit.
- Të garantohej akses më i plotë në databazat elektronike për oficerët e policisë gjyqësore, në përputhje të plotë me parimet e mbrojtjes së të dhënave.
- Të hartohet një procedurë për vlerësimet sistematike të efektivitetit të strategjive dhe praktikave të prokurorisë, përfshirë vlerësimet e vendimmarrjeve të prokurorisë.

## 6.3 Masat për ndërtimin dhe forcimin e kapaciteteve

---

- Të hartohet dhe të përditësohet një përmbledhje me aktet nënligjore të zbatueshme në Prokurorinë e Shqipërisë.
- Të kryhet një vlerësim i hollësishëm i nevojave për trajnim të prokurorëve, policisë gjyqësore në shërbime dhe policisë gjyqësore në seksione, bazuar në mangësitë e evidentuara, si p.sh. në fushën e metodave hetimore të veprave që kërkojnë aftësi të specializuara (p.sh. krimet ekonomike, krimet ndaj të miturve, dhuna në familje, rastet e korrupsionit të profilin të lartë, etj.).
- Të përgatitet një grup mjetesh praktike si manuale, procedura standarde operimi, udhëzime praktike, lista verifikimi/kontrolli, etj. për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore.
- Të zhvillohen aftësitë drejtuese të prokurorëve përmes programeve trajnuese dhe këshilluese si për prokurorët në shërbim ashtu edhe për prokurorët e sapoemëruar, me qëllim që të zbatojnë mendësi dhe teknika aktive drejtuese.
- Të mundësohet proces aplikimi i hapur dhe transparent në trajnimet që ofrojnë institucionet trajnuese.

## 7. Referencat

### 7.1 Bibliografia

Bureau of the Consultative Council of European Prosecutors, Report on the independence and impartiality of the prosecution services in the Council of Europe member States in 2017, CCPE-BU(2017) 6.

[Byroja e Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë, Raport për Pavarësinë dhe Paanshmërinë e shërbimeve të prokurorisë në Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës në vitin 2017, CCPE-BU (2017)7.]

Commission Staff Working Document Albania 2019 Report, Brussels, 29.5.2019 SWD(2019) 215 final.

[Dokument Pune i Komisionit, Raporti 2019 për Shqipërinë, Bruksel, 29.5.2019 SWD(2019) 215 final.]

Commission Staff Working Document Albania 2018 Report, Strasbourg, 17.4.2018 SWD(2018) 151 final.

[Dokument Pune i Komisionit, Raporti 2018 për Shqipërinë, Strasburg, 17.04.2018 SWD(2018) 151 final.]

Commission Staff Working Document Albania 2016 Report Brussels, 9.11.2016 SWD(2016) 364 final.

[Dokument Pune i Komisionit, Raporti 2016 për Shqipërinë, Bruksel, 9.11.2016 SWD(2016) 364 final.]

Commission Staff Working Document Albania 2015 Report Brussels, 10.11.2015 SWD(2015) 213 final.

[Dokument Pune i Komisionit, Raporti 2015 për Shqipërinë, Bruksel, 11.11.2016 SWD(2018) 213 final.]

Consultative Council of European Prosecutors (CCEP) Opinion No. 9(2014) on European norms and principles concerning prosecutors.

[Opinioni nr. 9(2004) i Këshillit Konsultativ i Prokurorëve Evropianë për normat dhe parimet evropiane lidhur me prokurorët]

If you are suspected of a criminal offence, The Council for the Judiciary, Netherlands, 2008.

["Nëse dyshohesh për një veprë penale", Këshilli për Gjyqësorin, Vendet e Ulëta, 2008].

Joint Investigation Teams Manual, Council of the European Union, 15790/1/11 REV 1, 4.11.2011.

[Manuali për Ekipet e Përbashkëta Hetimore, Këshilli i Bashkimit Evropian, 15790/1/11 REV 1, 4.11.2011]

McDonald, William F., Police-Prosecutor Relations in the United States, Executive Summary, US Department of Justice, National Institute for Justice, 1982.

[McDonald, William F., Marrëdhëniet Polici-Prokurori në Shtetet e Bashkuara, Përmbajtje Ekzekutive, Departamenti i Drejtësisë i SHBA-së, Instituti Kombëtar për Drejtësi, 1982.]

Police-Prosecutor Relations in the United States, Executive Summary, US Department of Justice, National Institute for Justice, 1982.

[Marrëdhëniet Polici-Prokurori në Shtetet e Bashkuara, Përmbajtje Ekzekutive, Departamenti i Drejtësisë i SHBA-së, Instituti Kombëtar për Drejtësi, 1982.]

UNODC, Handbook on practical anti-corruption measures for prosecutors and investigators, Vienna, 2004.

[UNODC, Manuali për masat praktike kundër korrupsionit për prokurorët dhe hetuesit, Vjenë, 2004.]

UNODC, United Nations Convention against Corruption: Article 11 implementation guide and evaluative framework, Vienna, 2015.

[UNODC, Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit: Neni 11 – udhëzues zbatimi dhe kuadër vlerësimi, Vjenë, 2005.]

## 7.2 Instrumentet ligjore

---

Kushtetuta e Republikës Së Shqipërisë.

Kodi i Procedurës Penale të Shqipërisë, 21.3.1995.

Ligji Nr. 95/2016 për Organizimin dhe Funksonimin e Institucioneve për Luftën kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Ligji Nr. 96/2016 për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën E Shqipërisë.

Ligji Nr. 97/2016 për Organizimin dhe Funksonimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë.

Ligji Nr. 108/2014 për Policinë e Shtetit (përditësuar me ndryshimet e Ligjit Nr. 112/2018 dhe Ligjit Nr. 58/2017).

Ligji Nr. 25/2019 për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.

Marrëveshje Bashkëpunimi për Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve të Policisë së Shtetit dhe Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve të Prokurorisë, 2017.

Marrëveshje Bashkëpunimi për të mundësuar zbatimin e planit të veprimit mbi luftën kundër krimin të organizuar midis Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm 6.11.2017.

Marrëveshje për Trajnimin e Vazhdueshëm të Oficerëve dhe Agjentëve të Policisë Gjyqësore midis Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrisë së Brendshme dhe Shkollës së Magjistraturës, 13.03.2011.

Urdhri Nr. 70 për përcaktimin e kompetencave të ushtrimit të kontrollit dhe ndjekjes penale nga Drejtoria e Hetimit e Prokurorisë së Përgjithshme, 9.02.2015.

Urdhri Nr. 251 i Prokurorit të Përgjithshëm për ngritjen dhe funksionimin e Njesisë së Hetimit të Korrupsionit dhe Pasurive pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda, 10.09.2015.

Udhëzim Nr. 2 i Prokurorit të Përgjithshëm për organizimin dhe bashkërendimin e punës së prokurorisë, 29.12.2016.

Udhëzim Nr. 1 i Prokurorit të Përgjithshëm për ngritjen e seksioneve të posaçme, 20.02.2018.

Urdhër i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Prokurorisë së Përgjithshme mbi funksionimin e shërbimeve policore gjyqësore në Policinë e Shtetit, 15.04.2008.

Memorandum Bashkëpunimi midis Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave, Shërbimit Informativ Shtetëror, ILDKPKI-së, dhe KLSH-së, 6.05.2009.

Shkresa Nr. 9 respektimin e afateve të hetimeve paraprake dhe afateve të tjera procedurale penale, 6.01.2004.

Urdhri Nr. 204 i Prokurorit të Përgjithshëm mbi ngritjen dhe funksionimin e njësive të përbashkëta të hetimit, 13.10.2009.

Urdhri Nr. 291 i Prokurorit të Përgjithshëm mbi funksionimin e prokurorisë së krimeve të rënda dhe marrëdhëniet e saj me prokuroritë e tjera dhe me policinë gjyqësore, 21.10.2004.

Udhëzim i përgjithshëm i Prokurorit të Përgjithshëm për hetimin e aseteve, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi, 20.1.2018.





